



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

**FAKULTETI I GJUHËVE KULTURAVE DHE  
KOMUNIKIMIT**

**TEMA E MAGJISTRATURËS  
FJALËFORMIMI NË PROZËN E FAIK KONICËS**

Kandidati:

Selvije Selmani

Mentori:

Doc.dr. Meral Veseli

Tetovë,  
Qershor, 2021

## PËRMBAJTJA:

PËRMBAJTJA.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Lista e tabelave: .....	4
ABSTRAKT .....	6
АΠСТΡΑΚΤ .....	6
ABSTRACT .....	7
HYRJE.....	9
Lënda e hulumtimit .....	9
Qëllimet e hulumtimit .....	10
Hipotezat .....	10
Metodologjia e hulumtimit .....	10
RËNDËSIA E PUNIMIT .....	11
I. Faik Konica .....	12
II. Fjalëformimi .....	16
III.FJALËT E PREJARDHURA.....	18
3.1 Prejardhja me parashtesim.....	18
3.2 Prejardhja me prapashtesim.....	25
3.3 Prejardhja me parashtesim e prapashtesim njëkohësisht.....	39
IV. KOMPOZIMI .....	42
4.1 Kompozita përcaktore sipas ndërtimit: .....	44
4.2 Kompozita këpujore.....	45
4.3 Grupimi i kompozitave sipas vlerës leksiko-gramatikore .....	46
V. NYJËZIMI .....	47
5.1 Mbiemra prejpjesorë .....	48
5.2 Emra prejfoljorë .....	48
VI. FORMAT E PËRZIERA.....	49
6.1. Përngjitje dhe prapashtesim .....	49
6.2. Nyjëzim dhe prapashtesim.....	49
6.3. Nyjëzim dhe parashteso-prapashtesim .....	49
6.4. Nyjëzim dhe përngjitje .....	50

6.5. Kompozim dhe ndajshtesim.....	50
VII. PËRNGJITJA .....	51
VIII. KONVERSIONI.....	53
IX. REZULTATET .....	55
X. KONKLUZAT .....	86
XI. BIBLIOGRAFIA.....	88

## Lista e tabelave:

Tabela 1: Fjalët e prejardhura me parashtesat: ç-, dez-, d(ë)-, jo-, mbi-, mos-, ndër-, nën-, pa- .....	56
Tabela 2: Fjalët e prejardhura me parashtesat: para-, për-, pro-, ri-, sipër-, stër-, sh-, zh- .....	57
Tabela 3: Fjalët e prejardhura me prapashtesat: -ar, -ant, -as(e), -atar, -acak, -an, -ak, -arak, -al, -avec, -azi .....	58
Tabela 4: Fjalët e prejardhura me prapashtesat –eshë, -ës, -(ë)ri, -(ë)si, -ë(sor), -e, ë(yi), -i, -ik(e), im .....	60
Tabela 5: Fjalët e prejardhura me prapashtesat: -ist, --(i)sht, --ishte, - izëm, -je, -log, -logji, -llëk, -nik, -osh, -onjës.....	61
Tabela 6: Fjalët e prejardhura me prapashtesat: -or, -ore, - qar, -shëm, -(tar)-e, -tor(e), -th, -ues, -ushe, -ushë, -xhi.....	63
Tabela 7: Paraqitja tabelare e fjalëve të prejardhura me parashtesa dhe prapashtesa njëkohësisht.....	64
Tabela 8: Analiza statistikore e fjalëve të prejardhura .....	64
Tabela 9: Paraqitja tabelare e kompozitave përcaktore sipas ndërtimit: emër+emër.....	69
Tabela 10: Paraqitja tabelare e kompozitave përcaktore sipas ndërtimit: emër+mbiemër, numëror/përemër i pacaktuar+ emër, ndajfolje+emër, emër+përemër i pacaktuar, përemër+emër.....	71
Tabela 11: Paraqitja tabelare e kompozitave këpujore sipas ndërtimit: emër+emër, emër+mbiemër, mbiemra të formuar me ndihmën e zanores lidhëse o .....	71
Tabela 12: Analiza statistikore e kompozitave .....	71
Tabela 13: Kompozitat e grupuara siaps vlerës leksiko-gramatikore: emërore, mbiemërore, ndajfoljore .....	74
Tabela 14: Paraqitja tabelare e mbiemrave prejpjesorë dhe emrave prejfoljorë.....	77
Tabela 15: Paraqitja tabelare e mënyrave të përziera: Përngjitje dhe prapashtesim, nyjëzim dhe prapashtesim, nyjëzim dhe parashteso-prapashtesim, kompozim dhe ndajshtesim, nyjëzim dhe përngjitje.....	79
Tabela 16: Paraqitja tabelare e fjalëve të përngjitura: emra të përngjitur, përemra të përngjitur, ndajfolje të përngjitura, lidhëza të përngjitura, numërorë të përngjitur, parafjalë dhe pjezësa .....	82
Tabela 17: Paraqitja tabelare e fjalëve të formuara me konvesion: Mbiemra-emra, emra- mbiemra, emër-ndajfolje, emër-parafjalë, folje- ndajfolje.....	84

## **Falënderim**

Për këtë punim masteri falënderoj mentoren time Doc.dr. Meral Shehabi dhe sinqerisht profesoreshën Doc.dr. Luljeta Adili, Prof.dr. Zeqir Kadriu, të cilët më përkrahën shumë dhe nuk përtuan të më ndihmojnë saherë që unë pata nevojë për ta. Mirënjohëse pafund familjes sime, e cila më qëndroi afër dhe më besuan në këtë rrugëtim. Gjithashtu një përkrahje të pakusht pata nga shoqëria ime që më ndihmuan dhe vazhdojnë të më ndihmojnë me shumë përkushtim.

## **ABSTRAKT**

Në fushën e gjuhësisë janë bërë dhe bëhen studime të shumta qoftë në morfologji, sintaksë, fonetikë, leksikologji e kështu me radhë. Fjalëformimi edhe pse shumë i rëndësishëm në fushën e gjuhësisë sidomos në pasurimin e gjuhës nuk është trajtuar aq sa duhet. Studimi i gjuhës së Konicës në aspektin e fjalëformimit është trajtuar shumë pak ose aspak, prandaj pamë të udhës që ky punim të ngërthejë një studim të të gjitha mënyrave të fjalëformimit në prozën e tij.

Objekt studimi në këtë tezë masteri është fjalëformimi në prozën e Konicës në veprat „Katër prralla nga Zullulandi”, „Shqipëria si m’u duk”, „Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, „Shqipëria - vendi shkëmbor i Evropës Juglindore” dhe shkrime të tjera.

Me anë të metodës përshkuese dhe analizës së fjalëve në aspektin e fjalëformimit janë trajtuar të gjitha mënyrat e fjalëformimit: prejardhja parashtesore, prapashtesore, njëkohësisht parashteso – prapashtesore, kompozimi, nyjëzimi, format e përziera, përngjitja dhe konversioni.

Fjalët jo të parme sipas mënyrës së fjalëformimit janë grupuar veç e veç, prej të cilave në numër shumë të madh janë fjalët e prejardhura me prapashtesa. Nga të gjitha mënyrat tjera prejardhja edhe në prozëne Konicës është mjaft e pasur dhe produktive me gjithsej 663 fjalë dhe më pas për nga numri i madh i fjalëve vjen kompozimi. Kompozitat janë grupuar sipas ndërtimit dhe sipas vlerës leksiko-gramatikore. Krijimi i mbiemrave përmes nyjëzimit gjithashtu është treguar mjaft prodhimtar. Të gjitha mënyrat tjera edhe pse në numër më të vogël janë gjithashtu të gjalla dhe produktive.

Fjalët çelës: Faik Konica, fjalëformim, fjalët e prejardhura, kompozim, nyëzim, përgjitje, konversion etj.

## **АПСТРАКТ**

Во областа на лингвистиката, направени се бројни студии по морфологија, синтакса, фонетика, лексикологија и сл. Зборообразувањето, иако е многу важно во

областа на лингвистиката, особено во збогатувањето на јазикот, не е соодветно третирано. Студијата за јазикот на Коница во однос на зборообразувањето е третирана многу малку или воопшто не е третирана, па затоа видовме соодветно во ова дело да вклучиме проучување на сите начини на формирање на зборови во неговата проза.

Предмет на проучување во оваа магистерска теза е зборообразувањето во прозата на Коница во делата „Четири приказни од Зулуланд“, „ Како ми се чинеше Албанија “, „Др. Ѓилпра ги открива корените на драмата на Мамурас “ „, Албанија - карпестата земја на Југоисточна Европа “и други списи.

Преку сеприсутниот метод и анализата на зборовите во однос на формирањето на датотеки се третираат сите начини на формирање на зборови: изведените зборови со сите поделби (претставка, наставка и истовремено претставка и наставка), композицијата, процесот на креирање придавки, мешаните форми, сраснатите зборови и конверзија.

Непредложните зборови се групирани одделно според зборообразувањето, од кои многу голем број се изведени зборови со наставки. Од сите други начини, изведувањето во прозата Коница е доста богато и продуктивно со вкупно 663 зборови, а потоа во однос на големиот број зборови доаѓа композицијата. Сложените зборови се групирани според конструкцијата и лексичко-граматичката вредност. Создавањето придавки преку конјугација исто така се покажа како доста продуктивна. Сите други начини иако во помал број се исто така живи и продуктивни.

Клучни зборови: Фаик Коница, зборообразување, изведени зборови, композиција, сраснати зборови, конверзија итн.

## **ABSTRACT**

There have been a lot of studies in the field of linguistics and its branches as in morphology, syntax, phonetics, lexicology and so on. Word formation as a very important feature in the field of linguistics for enriching the language hasn't been dealt with enough. There has been very little or no study on the Konica's language as far as the word formation is concerned. Therefore, we thought, it would be useful to cover all of the ways of word formation in his prose (writings).

The aim of this master thesis is studying the word formation in Konica's works: "Four tales from Zululand", "Albania how I saw it", " Dr. Gjilpera discovers the roots of Mamuras drama", "Albania, the rocky country of Southeastern Europe" and other writings.

All the ways of word formation are studied with a descriptive method and analysis of the words in the word formation aspect: the derivation with prefixation, suffixation, prefixation – suffixation (affixation) at the same time, compoundings, participle adjectives, mixed forms, blending and conversion.

Words with affixation are grouped apart, according to the way of word formation, from which, a great number of them are derivations with suffixes. From all the other ways, derivation is very rich and productive in the prose of Konica, with a total of 663 words, followed by compounding according to the number of words. The compoundings are grouped due to their construction and due to their lexical and grammatical value. Forming adjectives from the participles of the verbs has also resulted very productive. All the other ways of word formation, despite being fewer in number, they are also alive and productive.

Key words: Faik Konica, word formation, derivational words, compoundings, participle adjectives, blending, conversion, etc.



## HYRJE

### Lënda e hulumtimit

Njëri ndër emrat më të shquar të letërsisë dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi është padyshim, Faik Konica. Fjalën shqipe e pasuroi shumë me krijimet e tij në prozë e vargje, lëvroi bukur dhe bindshëm edhe esenë, u dëshmuoi i zoti në përkthime të shumta, bëri emër edhe si përkthyes dhe publicist. Emri i tij është sinonim i një dhuntie të jashtëzakonshme artistike, diturie të madhe dhe mbi të gjitha një njohës me shumë shije i gjuhës së bukur shqipe.

Me analizën fjalëformuese në prozën e Konicës do të zbulojmë tipat e ndryshëm të fjalëformimit, pra sistemin e formimit të fjalëve. Nga kjo pikëpamje do të analizohen fjalët jo të parme që përbëhen prej temës fjalëformuese dhe formatit fjalëformues në prozën „Katër përralla nga Zullulandi“ (Konica, Katër përralla nga Zullulandi, 2016, fv. 7-30), „Shqipëria si m’u duk“ (Konica, Shqipëria si m’u duk, 2016, fv. 31-82), „Dr.Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Maumrrasit“ (Konica, Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit, 2016, fv. 83-171), „Shqipëria – kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore“ (Konica, Shqipëria-Kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore dhe shkrime të tjera, 2016, fv. 184-331) dhe shkrime të tjera (*Ai vend i çuditshëm – Shqipëria, Prejardhja racore, Shqiptarët: çelësat për të kuptuar jetën dhe natyrën e tyre, Fustanella piktorike, Vetitë luftarake, Bejlerët dhe bajraktarët, Gjuha dhe letërsia, Feja, Lamtumirë Shqipërisë së Zogut*). Në temat jo të parme hasim formatin që quhet mjet fjalëformues, psh. te fjala përgjak – formati është për-; te fjala artar – formati është –ar; te fjala përmirësoj – formati (për...o) etj.

Në aspektin e fjalëformimit në prozën e Konicës kemi analizuar disa mënyra të fjalëformimit duke përfshirë prejardhjen me nëndrajt e saj: prejardhjen parashtesore, prejardhjen parapshtesore, prejardhjen parashteso-prapashtesore,nyjëzimin, kompozimin, përgjijtjen, konversionin si dhe të një numër i fjalëve të gjetura do të mundohemi t’i trajtojmë mënyrat e përziera siç janë: përngjitje dhe prapashtesim, kompozim dhe prapashtesim, nyjëzim dhe prapashtesim, nyjëzim dhe parashteso-prapashtesim, nyjëzim dhe përngjitje.

## Qëllimet e hulumtimit

Në gjuhën shqipe prapashtesat janë të shumta. Prapashtesat janë shumëherë më prodhimtare sesa parashtesat. Qëllimi i punimit është që të dalë në shesh mënyra e formimit të fjalëve me parashtesa, prapashtesa, njëkohësisht me parashetesa dhe prapashtesa, nyjzimi, konversioni, kompozitat, përngjitja dhe format e përziera në prozën e Faik Konicës. Janë shqyrtuar veçmas secila prej këtyre dhe në këtë mënyrë kemi nxjerrë në pah fjalë të formuara në mënyra të ndryshme.

„Njësia bazë e sistemit të fjalëformimit është tipi fjalëformues. Tipi fjalëformues përcaktohet: a) nga mënyra e fjalëformimit (parashtesim, prapashtesim, kompozim etj), b) nga pjesa e ligjëratës ku hyn tema fjalëformuese c) nga mjete (formati) konkret fjalëformues dhe kuptimi tipësor i tij, d.m.th. nga raporti kuptimor ndërmjet fjalës jo të parme dhe temës a temave fjalëformuese të saj“. (Shqipërisë, 2002, f. 58)

## Hipotezat

Me këtë studim ne do të parshtrojmë disa hipoteza:

Hipoteza e parë: Fjalëformimi në prozën e Konicës është i shumëllojshëm

Hipoteza e dytë: Mënyra e formimit të fjalëve me parapashtesa në prozën e Konicës është mjaft produktive

Hipoteza e tretë: Kompozitat në prozën e Konicës janë të shumta

## Metodologjia e hulumtimit

Gjatë këtij studimi do të analizohet mënyra e fjalëformimit në prozën e Faik Konicës. Do të përdoret metoda përshkuese, metoda e analizës së fjalëve dhe punimeve të ndryshme shkencore që janë bërë në këtë fushë, që do të përdoren në këtë tezë master.

## **RËNDËSIA E PUNIMIT**

Rëndësia e këtij punimi ka të bëjë me fushën e gjuhësisë shqiptare. Studimet që janë bërë në fushën e gjuhësisë asnjëherë nuk kanë qenë të mjaftueshme, ashtu siç nuk do të mjaftojë edhe ky studim që do të bëhet. Përeherë mbetet për t'u bërë më shumë. Në këtë punim do të mundohemi të paraqesim studimin e fjalëformimit në prozën e Konicës. Klasifikimi i fjalëve sipas mënyrës së formimit do të hedhë deri diku dritë sesa e pasur ishte gjuha e Faik Konicës dhe çfarë prurjesh të rëndësishme i dha gjuhësisë shqiptare në përgjithësi. Një analizë e tillë nuk është bërë për gjuhën e Konicës dhe shpresojmë që e njëjta të kontribuojë në fushën e fjalëformimit, fushë kjo që kohëve të fundit bën përpjekje që të pavarësohet nga morfologjia .

## I. Faik Konica

„Faik Konica është nismëtari i modernitetit shqiptar, që kërkon e zbaton një model të ri kulture shqiptare. Ai nacionalizmin e vet nuk e mbështet në himnizimin e përmallshëm të Shqipërisë e të shqiptarëve, por në qërimin e kulturës vendëse nga veshjet e këqija dhe të huaja, këshëtu që shkrimi i tij zakonisht merr ngjyrën e kritikës, përmbysjes, ndërtimit e kundërshtimit. Gjykoi rreptë në shqip fenomenet shqiptare të kohës pa snjë kursim, kurse zgjodhi, diskutoi e paraqiti para botës në gjuhë të tjera vlerat e zgjedhura kulturore të shqiptarëve: letërsi, arte, etnologji e histori“. (Hamiti, Letërsia moderne shqipe, 2009, f. 67)

„Në fushën e letërsisë ai kritikonte shpërthimet nacionaliste shpesh vulgare për virtytet e larta të shqiptarëve dhe bënte thirrje për një qëndrim më realist e më kritik ndaj vendit të vet me të gjitha të metat e tij.“ (Elsie, 1997, f. 271)

„Aurel Plasari ka thënë për Konicën : „Që në kolegji e quanin „ filozofi“, letërsia dhe historia e interesonin në të njëjtën masë, gjuhësia, filologjia, muzika, politika, antropologjia kulturore, arkeologjia nuk e interesonin më pak.“

Ai e bëri revistën ALBANIA tribunë të gjuhës shqipe. Fan Noli, një tjetër figurë kombëtare e të njëjtës lartësi, e cilëson Konicën si lëvtronjës të hollë të gjuhës shqipe“. (Kontributi gjuhësor i Konicës, 2007).

„Përgjatë 12 viteve të botimit (1897-1909), ALBANIA qe vepra më madhore e Rilindjes, arena më e madhe e betejave për ndërlidhjen e sërishme të hallkave të shpirtit të kombit me shpirtin dhe frymën evropiane. Revista u bë agorë debatesh të rëndësishme dhe tribunë polemikash të zjarrta me teh volterian. Albania, krahas dhe në mënyrë të barabartë me gazetat tjera belge, merrte pjesë në formimin e mendimit publik evropian. Prandaj e meritoi respektin e evropianëve, gjë që flet për gjenialitetin e drejtuesit të saj 20 vjeçar, i cili, në dallim prej rilindasve të tjerë, betejën për shpëtimin e kombit e bëri në qendrat më të mëdha evropiane, aty ku propagandat satinizuese antishqiptare ishin më të zëshme dhe më të kobshme“. (Sulejmani, 2011, fv. 21-21)

„Konica e përfaqësoi Shqipërinë e Ahmet Zogut në Uashington nga viti 1926 deri më 1939. Gjatë kësaj kohe, ai u bë njeriu, që ndonëse fliste në emër të një vendi të vogël, famën e kishte të madhe“. (Ikonomi, 2017, f. xiii)

Prurjet e Konicës në gjuhësinë shqiptare janë të shumta për shkak se ishte një njohës dhe mjeshtër i madh i fjalës shqipe. Këtë kontribut të jashtëzakonshëm me një dashuri të zajrrtë e të pastër e dha përmes shumë krijimeve të tij letrare dhe sidomos përmes revistës „*Albania*“ në të cilën përpos çështjeve të ndryshme që u trajtuan, nuk mungoi edhe kontributi letrar e gjuhësor. Faik Konica shpeshherë kishte ngritur zërin për ta pastruar gjuhën shqipe nga ndikimet e fjalëve të huaja. Vazhdonte të punonte me zell për këtë rrugëtim sa të vështirë, por edhe sfidues njëkohësisht.

„Konica në revistën e vet u mor me shqipen e shkruar, me pasurimin dhe përpunimin e saj në nivel teorik dhe në nivel praktik: së pari me botimin e teksteve të veta rreth disa çështjeve kryesore të shqipes së kohës së tij dhe të shqipes së projektuar për të ardhmen; së dyti, inicioi, madje edhe motivoi shkrimtarë e gjuhëtarë, shqiptarë e të huaj, që në faqet e *Albanisë* të dikutonin çështjet e hapura lidhur me shqipen; së treti që është më e rëndësishmja, i botoi tekstet letrare të autorëve më të njohur shqiptarë të kohës, duke e parë zhvillimin dhe pasurimin e shqipes letrare në krijim e sipër, në vepër e sipër, si në rafshin e krijimit individual, poashtu edhe në rafshin e standardizimit të një gjuhe të përbashkët letrare.

Konica kishte njohje dhe dije gjuhësore për shqipen, por kishte edhe diçka më shumë, ndjenjën për shqipen e shkruar sidomos, që është veti jo shumë e shpeshtë edhe në mesin e krijuesve. Shqipja e tij është origjinale në fjalor, në shprehje, në fjali të shkurtër e të prerë, më shpesh me një tendosje të theksuar emocionale, e më rrallë me një fjali të harmonizuar klasike që e përmban drejtpeshimin emocional. Me një shqipe të kulluar ai ka krijura disa nga faqet më të bukura të prozës shqipe deri më sot, të cilat lexohen me fascimin për idetë dhe për shqipen e kulluar ku shkëlqejnë format e kuptimit në një sfond kombëtar“. (Hamiti, *Letërsia moderne shqipe*, 2009, fv. 169,173,174)

„Është e veçantë të theksohet se Faik Konica edhe në këtë aspekt do të jetë përherë origjinal: edhe kur i merr shprehjet popullore dhe i thur në tekstin e vet të prozës ai këto i shenjon hapatas si citate që nuk janë të tij, pokështu edhe shprehjet letrare i që merr nga kultura e

vet letrare nga të tjerët. I kapur në zjarrminë e vet krijuese me një motivacion të shkallës së lartë mbi fjalët dhe shqiptimin e tyre letrar ai edhe mundi të krijojë forma fjalësh të reja, lidhje të reja dhe kuptime të reja. Këtu hyjnë edhe format origjinale letrare si janë proza poetike, madje edhe vetë proza që shpesh me ritmin e vet të rregullt i afrohet poezisë. Prandaj në leximin e veprës së tij përnjeherë e njohim edhe aktin estetik, procesin e gjallë të krijimit, edhe objektin estetik, veprën letrare të mbaruar si vepër“. (Hamiti, Studime letrare, 2003, f. 332)

„Jeta e shpërndarë nëpër botë, fati i mërgimtarit të përhershëm, nevojat e lëvizjes kombëtare shqiptare dhe lidhjet me metropolet e kulturës botërore, aftësitë e shumanshme dhe interesat e gjera të projektuara në kushte të ndryshme historike, të gjitha këto kanë përcaktuar natyrën e tij praktike të veçantë e intelektuale. Vepra e tij është përhapur në dhjetra organe shqiptare e të huaja, në ato që drejtoi vetë, ai „Albania“ e „Dielli“ po mbeti edhe në dorëshkrime, fati i të cilave nuk dihet ende. Prej këndeje e ka burimin ai fenomen që ndodh me Konicën, më shumë se me çdo personalitet tjetër të kulturës sonë, që ndeshemi me „zbulime“ të herëpashershme. Këto zbulime shtrihen nga shkrime të shkurtra e deri te vepra madhore“. (Jorgaqi, 2004, f. 6)

„Konica është një një kundërthëniesh, që burojnë jo vetëm nga karakteri, por edhe nga konteksti socila-historik. Janë vënë në dukje shumë merita të personalitetit të tij: erudit, poliglot, atdhetar, publicist, shkrimtar, stilist i rrallë, diplomat, evropian i amerikanizuar, aristokrat e progresist etj., vyrtete që plekseshin në një mënyrë të çuditshme me të meta e dobësi: grindavec, snob, inatçor, prepotent i papërmbajtur, elitar, përbuzës i ashpër, i vulgut, pragmatist, inkohorent etj. Kjo pleksje meritash e mëkatesh të skajshme e bën Faik Konicën një hiperbolë me nuanca ekscentrike groteske si personalitet, si individ. Për më tepër, nga njëri pol (virtutesh) në polin tjetër (mëkatesh) kalimet janë të papritura, të menjëhershme, të habitshme. Sigurisht, të tilla s'janë vetëm inkoherenca të karakterit individual, por edhe të zhvillimeve kaotike, iracionale, kthesave e përmbysjeve të papritura dhe kundërthënieve të vetë jetës, kombit, atdheut, që e përcollën tërë jetën e tij“. (Uçi, 2003, fv. 106-107)

Konica shfaqet njeri me shije dhe dije letrare, me kuptimin për ulitaritetin e letërsisë dhe për artin e pastër letrar dhe me një dashuri e talent pës shqipen e pasur, të pastër e të natyrshme. Këtu gjejë mbështetje mendimet që e vlerësojnë Konicën, jo vetëm njëherë, si krijues të prozës shqipe. E ai vetë mund të shtojë edhe këtë në fund për përkthimin e vet: „Që të ketë përkthimi

edhe njëfarë vlere letrare, u kujdesmë që shqipia e përdorur të jet' e gjallë dhe sa më tepër e çliruar nga fjalë të ra të panevojshme“. (Hamiti, Studime letrare, 2003, fv. 296-297)

Nasho Jorgaqi në librin *Antologji e Faik Konicës* me të drejtë shprehet se për një gjë jemi të sigurtë: që Konica, tani për tani, qëndron mes të njohurës dhe të panjohurës. S'ka dyshim se vlerat kryesore janë zbuluar, por përmasat e vërteta të këtij personaliteti të shquar s'mund të jenë të plota në qoftë se trashëgimia e tij nuk njihet deri në fund. Zbulimet e herëpashershme janë dëshmi e qartë e ekzistenës së një fondi vlerash që pret në dritë. Ato përbëjnë tanimë një realitet të pakundërshtueshëm, po dhe një shpresë se një ditë Faik Konica do të kthehet i tëri në kulturën shqiptare. (Jorgaqi, *Antologji e Faik Konicës*, 2004, fv. 7-8)

## II. Fjalëformimi

„Si problem i patrajtuar deri vonë, deri në periudhën para Luftës, ka qenë formimi i fjalëve. Edhe pse historia e gjuhës shqipe nis më herët, problemet e fjalëformimit kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve më vonë. Të parët që u morën me këtë çështje, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi, ishin studiuesit e huaj, por materialet e tyre i trajtuan vetëm në planin historik. Studiuesit shqiptarë, edhe pse njohës të gjuhës shqipe, ashtu të paktë si ishin, të ndikuar nga studiuesit e huaj, shumë pak hapësirë i dhanë fjalëformimit në punët e tyre.“ (Çeliku, 2020, f. 29)

„Fjala mund të analizohet nga pikëpamja e përbërjes morfematike dhe nga mënyra e formimit. Në analizën morfematike të fjalës caktohen morfemat prej të cilave përbëhet ajo, domethënë bëhet zbërthimi i fjalës në rrënjë, parashtesë, prapashtesë dhe mbaresë, si pa-aftë-si-a, krye-qytet-as-it etj. Pra, qëllimi i analizës morfematike është identifikimi i morfemave të fjalës.

Analiza fjalëformuese zbulon mënyrën e bashkimit të morfemave që përbëjnë një temë jo të parme. Përmes kësaj analize gjenden tipat e ndyshëm të fjalëformimit që veprojnë në gjuhë. Në radhë të parë gjendet tema fjalëformuese (ose temat fjalëformuese) dhe pastaj mjetet fjalëformuese (parashtesat dhe prapashtesat).“ (Universiteti, 1998, f. 127)

„Pra, siç del nga kjo paraqitje e shkurtër, detyrat e analizës morfematike dhe të analizës fjalëformuese nuk janë të njejta. Në qoftë se analiza morfematike u përgjigjet pyetjeve: cila është përbërja morfematike e fjalës, cilat janë morfemat e saj, analiza fjalëformuese i jep përgjigje pyetjes: si është formuar fjala e dhënë? Në të vërtetë, gjatë analizës morfematike ne shkojmë nga fjala e prejardhur drejtpërdrejt te morfema rrënjore, ndërsa gjatë analizës fjalëformuese shkojmë nga fjala e prejardhur te tema fjalëformuese. Pra, analiza morfematike jep mundësi të zbulohen faktet gjuhësore konkrete, të dallohen te fjala të gjitha pjesët përbërëse të saj, analiza fjalëformuese jep mundësi të depërtohet në procesin e formimit të fjalës dhe të zbulohet rendi i bashkimit të morfemave njëra me tjetrën në procesin e fjalëformimit.“ (Hysa, Formimi i emrave me ndajshesa në gjuhën shqipe, 2004, f. 55)



„Shkalla e motivimit varet edhe nga qartësia e lidhjeve kuptimore ndërmjet temës fjalëformuese dhe fjalës së prejardhur, ndërmjet morfemave fjalëformuese brenda fjalës dhe shkallës së prodhimit të tyre.“ (Thomai, Prejardhja semantike në gjuhën shqipe, 1989, f. 273)

„Fjalëformim quhet formimi i fjalëve të reja në një gjuhë me mënyra e me mjete të ndryshme, si rrugë kryesore për pasurimin e fjalorit.“ (SHQIPËRISË A. E., Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, 1980, f. 480)

„Lidhjet e ngushta të fjalëformimit me leksikun, nga njëra anë, dhe me gramatikën, nga ana tjetër, pasqyrohen edhe në pasurinë e mënyrave të fjalëformimit në gjuhën shqipe. Këto mënyra janë:

1. Prejardhja me nëndarjet e saj:
    - a) Prejardhje parashtesore,
    - b) Prejardhje prapashtesore,
    - c) Prejardhje parshteso-prapashtesore,
    - d) Prejardhje pa ndajshitesë.
  2. Nyjëzimi
  3. Kompozimi
  4. Përngjitja
  5. Konversioni
  6. Mënyrat e përziera:
    - a) Përngjitje dhe prapashtesim,
    - b) Kompozim dhe prapashtesim,
    - c) Nyjëzim dhe prapashtesim,
- ç) Nyjëzim dhe parshteso-prapashtesim
- d) Nyjëzim dhe përngjitje.

Mënyrat e mësipërme të fjalëformimit ndahen në: a) mënyra morfologjike, që janë: ndajshitesimi, nyjëzimi, kompozimi; dhe b) mënyrat jomorfologjike: përngjitja dhe konversioni.“ (Shqipërisë A. e., 2002, fv. 59-60)

### III.FJALËT E PREJARDHURA

„Prejardhja është mënyra më prodhimtare dhe më e larmishme në sistemin e fjalëformimit të shqipes. Prejardhje quhet formimi i fjalëve të reja me anë të bashkimit të një ndajstese fjalëformuese me tema fjalësh ose me fjalë. Fjalët e shqipes organizohen në familje rreth një fjale të thjeshtë (ose një fjale rrënjë) . Fjala rrënjë mund të jetë një emër (art), një mbiemër (i pastër), një folje (hap). Ajo mund të shërbejë për të krijuar një emër tjetër, një mbiemër, një folje ose ndajfolje.

p.sh art (emër) ---- artist (emër) -----artistik (mbiemër) ----- artistikisht (ndajfolje).

Fjalët e prejardhura formohen duke i shtuar temës fjalëformuese parashtesa, prapashtesa ose të dyja së bashku. Parashtesat dhe prapashtesat nuk janë fjalë, po elemente fjalësh. Parashtesat vendosen para fjalës rrënjë, ndërsa prapashtesa vendoset pas rrënjës dhe në më të shumtën e rasteve ndryshon klasën gramatikore të fjalës bazë.“ (Beci, 1997, f. 131)

„Sipas vendit të ndajstesave dhe sipas llojit të lidhje së tyre me rrënjën, fjalët e këtij tipi janë tri llojesh:

- a) Fjalë të formuara me parashtesim
- b) Fjalë të formuara me prapashtesim
- c) Fjalë të formuara njëkohësisht me parashtesim dhe prapashtesim“

(Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, 2002, f. 155)

#### 3.1 Prejardhja me parashtesim

„Parashtesimi është nëntip i veçantë i formimve ndajstesore, krahas prapashtesimit dhe parashteso-prapashtesimi, pesha e të cilit është realtivisht e kufizuar, e vogël në krahsim me dy të parat. Parashtesimi, në kuadrin e formimeve me ndajstesa, zë një vend më të vogël se prapashtesimi. Ky fakt gjen shpjegimin e vet në disa arsye. Në radhë të parë numri i parashtesave

është më i vogël se ai i prapashtesave; në radhë të dytë ka mjaft prapashtesa që janë shumë prodhimtare dhe që në këtë mënyrë kanë krijuar një numër të madh fjalësh. Nga ana tjetër ka mjaft parashtesa që janë bërë arkaike, që janë vjetëruar, që kanë dalë jashtë përdorimit, ose dhe të tjera, që sapo kanë hyrë në përdorim me rrugë të ndyshme, por që tani për tani nuk kanë ndonjë prodhimtari aq të gjerë.

Fjalët e formuara me parashtesim në gjuhën shqipe janë më të pakta, sesa ato me prapashtesim, sepse gjuha jonë ka më pak parashtesa se prapashtesa. Në punimin e Aleksandër Xhuvanit dhe Eqrem Çabejt „Parashtesat e gjuhës shqipe“ (1956) janë përfishirë 68 parashtesa të gjuhës shqipe, por një pjesë e tyre tashti ose janë krejt të vjetruara, ose janë më pak prodhuese. Të tilla janë parashtesat e dikurshme n-, m-, s-, a-, kë, etj. (p.sh. ngrin, ngul, ngarkoj, mbuloj, mbath, skamje, sëmundje, ashtu, kështu). Në gjendjen e sotme të gjuhës shqipe a-, kë- e ndonjë tjetër nuk merren më si parashtesa.“ (E.Hysa, 2004, fv. 40,155)

„Parashtesa nuk ia ndërron kategorinë leksiko-gramatikore fjalës me të cilën bashkohet, por i jep asaj vetëm një kuptim të ri plotësues. Ka edhe një varg fjalësh të formuara me parashtesa, që i përkasin një pjese të ndyshme të ligjëratës në krahasim me temën fjalëformuese (nga një temë emërore formohet një folje), p.sh. *përbalt (balt)*, *përbuzë (buzë)*, *përgjak (gjak)*, *mburr (burrë)*, *shfaq (faqe)*. Në këto raste fjala është formuar jo thjesht me parashtesim, po me një mënyrë të përzier, parashtesim dhe prejardhje pa ndajshitesë (si *te shosh* < *shoshë*, *ndryshk fol.* < *ndryshkem*).“ (Shqipërisë A. e., Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia I, 2002, f. 61)

Jani Thomai në *Leksikologjia e gjuhës shqipe f.156-157* ka bërë edhe një grupim se cilat nga klasat e fjalëve janë më të pasura që janë formuar përmes parashtesimit.

„-Emrat foljorë, që kanë *kuptimin e veprimit* janë formuar me parashtesën mos-, si mosbindje etj. Emrat e formuar me këtë parashtesë kanë kuptim të kundërt me emrat përkatës pa këtë parashtesë.

-Kuptim të kundërt me fjalët përkatëse kanë edhe disa emra *me kuptimin e cilësisë atë gjendjes*; që janë formuar me parashtesën pa-, si: pakënaqësi etj. Por, më të shumtë janë mbiemrat me kuptim mohues, që janë formuar me këtë parashtesë, si: i paqartë, i padrejtë etj.

- Një tok emrash e foljesh *me kuptime të ndryshme* janë formuar me parashtesat *bashkë-, para-, prapa-, (pas-), kundër-, sipër-* etj.

- Kanë kuptim të kundërt ose kuptim intensiv edhe disa mbiemra e folje, që janë formuar me parashtesat *sh-, ç-, zh-, z-, s-*, si: shpalos, shkëmbej etj.

- Një klasë të madhe përbëjnë foljet që janë formuar me parashtesën *për-, me kuptim intensiv* ose me ndonjë kuptim tjetër, si: përforcoj etj

- Klasa e foljeve me parashtesën *ri-, me kuptimin e përsëritjes* ose të nisjes nga e para të një veprimi, si: rilexoj, rishkruaj etj.“

„Parashtesimi në gjuhën shqipe është zhvilluar në lidhje të ngushtë me përngjitjen, nga njëra anë, dhe me kompozimin nga ana tjetër. Shndërrimi i disa parafjalëve e pjesëzave në parashtesa e ka burimin te përngjitja. Marrëdhëniet midis këtyre dy mënyrave të fjalëformimit edhe sot janë mjaft të gjalla dhe në dia raste nuk është e mundshme të hiqet një kufi i prerë ndërmjet tyre. Pra, dallimi i parashtesimit nga përngjitja e kompozimi nuk është i thjeshtë. Për të arritur në një zgjidhje të drejtë, përveç disa rregullave të përgjithshme, duhet të merret parasysh për çdo fjalë mënyra e motivimit dhe natyra leksiko-gramatikore e elementit të parë. Ka fjalë të veçanta për të cilat mund të pranohen dy mënyra interpretimi: parashtesim ose përngjitje, parashtesim ose kompozim.“ (Shqipërisë A. e., Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia I, 2002, fv. 62-63)

Në *Gramatikën e gjuhës shqipe Morfologjia I f.63*, gjithashtu përmenden edhe parashtesat e huaja. Në gjuhën shqipe kanë hyrë edhe një numër parashtesash të huaja, si: *a-, anti-, dez-, dis-, pro-, pan-, trans-, ultra-* etj. Parashtesat ashtu si edhe prapashtesat, huazohen jo si të tilla, por nëpërmjet fjalëve të formuara me anë të tyre.

Fjalët e prejardhura me parashtesat: **ç-, dez-, d(ë)-, jo-, mbi-, mos-, ndër-, nën-, pa-, para-, për-, pro-, ri-, sipër-, stër-, sh-, zh-** në prozën e Konicës:

Parashtesa **ç-**

„Për historinë e kësaj parashtese Çabej thotë se ka rëndësi që me këtë trajtë del që te Gjon Buzuku, **me çpërthyhem,çkushulluom**. Trajta të tilla ka edhe P. Budi me P. Bogdanin,

**çkrepem, për të çpejtë, të çtjella, me çprishunë** etj. Kështu këto trajta janë (ose kanë qenë), edhe të gegërishtes dhe janë të një farë moshe në gjuhë.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 154)

I çpenguar, çmorritur, çnderojë, çlodhet, i çdehur, t'i çkuptojë, të çkombëzuar, i çsojësuar.

Parashtesa **dez-**

Në prozën e Konicës kemi hasur një fjalë me parashtesën **dez-** që ka një kuptim të kundërt me atë që shënon tema fjalëformuese. Parashtesat **de-, dis-, dez-**, Enver Hysa në librin *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhë shqipe* f.99 i quan parashtesa të huaja që në shqipe u përgjigjen parashtesat ç-, sh- që pjesërisht mund t'i zëvendësojë ato.

**Dez**organizohet

Parashtesa **d(ë)-**

„Parashtesa **dë** u ngjitet si parafolje disa foljeve, duke u dhënë kuptim intensiv, ndonjë foljeje, me funksion antonimi dhe disa emrave.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 155)

**Dë**borë (borë)

Parashtesa **jo-**

Në *Gramatikën praktike të gjuhës shqipe* f.310 thuhet se kjo parashtesë bashkohet me mbiemra për të formuar mbiemra me kuptim të kundërt., Në gjuhë të shkrimit me **jo** janë formuar mjaft fjalë me kuptim antonimi.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 156) Në prozën e Konicës kemi hasur disa mbiemra të këtillë.

**Jot**ipike, **josh**kencor, **jop**jellor, **jo**origjinale, **jog**rekë, **josh**qiptar,

Parashtesa **mbi-**

„Kjo parashtesë në gjuhën shqipe nuk është shumë produktive në gjuhën popullore, por në gjuhë të shkrimit përkundrazi, me këtë parashtesë janë formuar, me anë përkthimesh,

kalkesh, mjaft fjalë, kryesisht emra, folje e mbiemra, më fort të sferës abstrakte.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 165)

**Mbiquaj, mbishkrimeve**

Parashtesa **mos-**

Sipas Enver Hysës në librin *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe* f.82 elementi **mos** është nga të paktat pjesëza që kanë kaluar në formate fjalëformuese parashtesore. Kuptimi themelor i *mos*-it si parashtesë është kuptimi i kundërt me atë të fjalës që i vihet përpara, që ju jep fjalëve të formuara me të.

**Moskuptime, mospëlqim, mosmarrveshje, mosdukje, mosndyshim, moskokëçarës, mostoleranca, mosmiratim, moskurorëzim,**

Parashtesa **ndër-**

Në librin *Studime gjuhësore III*, f.168 Çabej shprehet se kjo parashtesë, e cila në thelb është parafjala **ndër, nër**, u ngjitet emrave, mbiemrave, foljeve, ndajfoljeve, parafjalëve dhe lidhëzave.

**Ndërmarrje**

Parashtesa **nën-**

Sipas Çabejt në librin *Studime gjuhësore III*, f.168 kjo parashtesë në gjuhën e shkrimit e ka shtrirë përdorimin e saj nga emrat edhe në foljet, edhe këtu më fort me përkthime nga gjuhët e huaja.

**Nënqesh, nënshkrim, nënlloj, nënshtrim, nënkuptim.**

Parashtesa **pa-**

Kjo parashtesë sipas Çabejt në librin *Studime gjuhësore III*, f.169-171 gjindet në disa fjalë të gjuhës popullore, kurse në gjuhë të shkrimit është bërë produktive, duke iu ngjitur emrave, mbiemrave e ndajfoljeve. Sa për etimologjinë e parashtesës **pa-**, kjo lidhet me sanskritishten **apa**, latinishten **po-** në **positus**, etj.

I **pabesë**, i **panjohur**, i **paarmatosur**, të **pamëshirshëm**, të **pakalueshëm**, i/e **paprekshëm**-e, i **padurueshëm**, i **pashprehur**, të **pakëndshme**, i **padurueshëm**, i **paqëndrueshëm**, i **papajtueshëm**, të **pabotuar**, i **pandershëm**, i **padëmshëm**, i **palarë**, të **pakrehur**, të **parrojtur**, i **pamohueshëm**, e **paprekshme**, **padije**, të **patrazuar**, e **pandarë**, i **pasjellshëm**, të **pashkëputur**, e **papajtueshme**, e **pazonja**, i **paditur**, e **paskrupull**, i **patundur**, i **pagdhendur**, i **pavarur**, i **pashkruar**, i **pagabuar**, e **pandarë**, e **pavarur**, i **papërcaktuar**, i **pakënaqur**, të **papritura**, i **papërditësuar**, i **pandërprerë**, e **pakufishme**, e **padobishme**, e **paarsyeshme**, e **panumërta**, të **pafajshëm**, të **palezetshme**, i **pasjellshëm**, i **padurueshëm**, të **palavdishme**, të **pamëshirshëm**, e **paprekshme**, të **pakalueshme**, i **pakujdesshëm**, e **pafajshme**, i **pashpirt**, të **pasigurta**, i **pandershëm**, i **pangopur**, i **paturbulluar**, i **pavdekur**.

#### Parashtesa **para-**

Në librin *Studime gjuhësore III* f. 171 Çabej thotë se me anë të parashtesës para formohen emra, mbiemra e folje të ndyshme. Kjo parashtesë jep idenë e një gjëje, të një gjendje atë një veprimi që kryhet përpara një tjetri. Në prozën e Konicës hasëm disa shembuj të tillë.

**Parapëlqej**, **pararomake**, **paragjykim**, **paraturk**.

#### Parashtesa **për-**

„Parashtesa **për** u ngjitet emrave, mbiemrave, foljeve e ndajfoljeve duke u dhënë kuptime të ndryshme. Sipas Pedersenit e Joklit kjo parashtesë është autoktone në gjuhën shqipe.“ (Çabej, *Studime gjuhësore III*, 1987, fv. 172-173)

**Për**qesh (qesh), **për**jetë (jetë), **për**brenda (brenda), **për**shkruhet (shkruhet), **për**mbys (mys), **për**mbledhur (mbledh), **për**mbyty (mbyty), **për**fitoj (fitoj), **për**ballë (ballë), **për**punon (punon), **për**hap (hap), **për**shkrim (shkrim), i **për**çarë (çarë).

#### Parashtesa **pro-**

Çabej në librin *Studime gjuhësore III*, f. 175 shprehet se kjo parashtesë haset në pak fjalë të gegërishtes veriore. Në disa fjalë të gjuhës së shkrimit me burim grek e latin, na del një **pro-** e këtij burimi.

**proshqiptar**

### Parashtesa **ri-**

Me anë të kësaj parashtese përsëritet një veprim ose një gjë. Çabej thotë: „*Kjo parashtesë ka rrjedhur nga italishtja, **ri-** si te fjala **rimanere**, por duhet të ketë ndikuar edhe fjala shqipe i ri, me formimet e saj sërish, përsëri etj. khs. **i rii** lenë „**regeneratus**“ te Buzuku.*“ (Çabej, Studime gjuhësore, 1987, f. 176)

**Ringjallte, rifitoi, ripërcaktim, rivendosur, rikujtojmë.**

### Parashtesa **sipër-**

Sipas Enver Hyës në *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, f.69 parashtesa **sipër-** që në gjuhën shqipe, jashtë strukturave të ngjizura, njeh dhe përdorimin ndajfoljor dhe atë parafoljor, nuk është prodhimtare, as e gjallë.

### **Sipërmnatyrshme**

### Parashtesa **stër-**

Enver Hysa në librin *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, f.76-77 shprehet se parashtesa **stër-** nga pikëpamja e origjinës lidhet me latinishten **extra** ame italishten **stra-**, me të cilat shkon edhe rumanishtja **stra-**. Nga pikëpamja kuptimore parashtesa stër- u jep fjalëve me të cilat bashkohet një kuptim zmadhimi a teprie.

**Stërgjyshër (gjysh), stërnip (nip).**

### Parashtesa **sh-**

Kjo parashtesë sipas Çabejt në *Studime gjuhësore III*, f.179-180 u ngjitet emrave, mbiemrave, foljeve e ndajfoljeve, me funksione të ndryshme, ose pa ndonjë funksion të dukshëm. Janë bërë normë e gjuhës letrare trajtat me **sh-**, kur parashtesa ndiqet nga një bashkëtingëllore e shurdhët (**f, k, p, q, t, th**).

**Shpërdorim, shkujdesur.**

### Parashtesa **zh-**



Parashtesa **zh-** sipas Çabejt në *Studime gjuhësore III*, f. 185 u ngjitet disa emrave dhe foljeve, me funksione të ndryshme.

**Zhbëjmë, zhveshnë.**

## 3.2 Prejardhja me prapashtesim

„Fjalë të formuara me prapashtesim, kur janë formuar nga një temë prodhuese dhe me prapashtesë. Temë prodhuese mund të jetë tema e një fjale të parme, të prejardhur, të përbërë a të përngjitur. Fjalët e formuara me mënyrën e prapashtesimit në gjuhën shqipe janë më të shumta se ato me parashtesim, sepse gjuha jonë ka më shumë prapashtesa se parashtesa. Në punimin e Aleksandër Xhuvanit dhe Eqrem Çabejt „Prapashtesat e gjuhës shqipe“ (1962) janë përfshirë rreth 170 prapashtesa të gjuhës shqipe (veç prapashtesave foljore), shumica e të cilave janë shumë prodhuese.“ (Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, 2002, f. 157)

„Ndërmjet rrugëve që shfrytëzohen për pasurimin e leksikut të shqipes, jo vetëm në fushën e emrave, por edhe në fushën e mbiemrave, të foljeve dhe të ndajfoljeve, vendin qendror e zë formimi me prapashtesa si për larminë më të madhe të mjeteve ashtu edhe për prodhimtarinë më të madhe. Ndryshe nga parashtesat, prapashtesat që veprojnë në fushën e emrave nga pikëpamja kuptimore kanë një farë uniteti, në vështrimin që për të shprehur, p.sh. kuptimin e veprimit, përdoren një numër i caktuar prapashtesash. Kështu në fushën e emrave në gjuhën shqipe dallohen: a) grupi i prapashtesave që formojnë emra abstraktë veprimi, gjendjeje dhe cilësie, b) grupi i prapashtesave që formojnë emra vepruesish dhe personash sipas mjeshtërisë që kryejnë, ose sipas vendit ku banojnë a nga rrjedhin, c) grupi i prapashtesave që formojnë emra sendesh ose veglash. Këto përbëjnë dhe tri fushat themelore fjalëformuese të sistemit të prapashtesave të emrave në gjuhën shqipe, por së pari, këto nuk janë të vetmet dhe së dyti, brenda përbrenda tyre ka një larmi mjetesish dhe kuptimesh, që përfshihen në secilën nga këto tri fusha. (Hysa, Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe, 2004, f. 107)

„Me anë prapashtesash formohen emra, mbiemra, folje, ndajfolje, prej po asaj pjese të ligjëratës: p.sh, emra: orizore (< oriz), bukuri (< i bukur), çelës (< çel); mbiemra: i artë (< ar),

bukurosh (< i bukur), i sotëm (< sot); folje: punoj (< punë), liroj (< i lirë), largoj (< larg); ndajfolje: vazhdimisht (< vazhdim), ligsht (lig < i lig), krejtësisht (< krejt) etj.

Prapashtesat në përgjithësi kanë funksion klasifikues, d.m.th bashkë me kuptimin e ri që i japin temës së cilës i ngjiten, përcaktojnë edhe pjesën e ligjëratës ku hynë fjala e re. Kjo shihet qartë te shembujt e sjellë më sipër. Por ka edhe prapashtesa që shërbejnë për të formuar dy pjesë të ndyshme të ligjëratës, p.sh. emra dhe mbiemra, si prapashtesat *-(ë)s, -ar, -tar, -or, -tor: nxënës, gazetar, gjahtar, drejtor, fajtor* (emra); *tërheqës, legjendar, mesdhetar, arsimor, leshtor* (mbiemra).“ (Shqipërisë A. e., Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia I, 2002, f. 64)

Jani Thomai në librin *Leksikologjia e gjuhës shqipe* thotë se në fjalët e formuara me prapashtesë ka shumë klasa të pasura dhe përmend më kryesoret:

### **„Në emrat:**

Emrat e vetave a të sendeve vepruese d.m.th. të njerëzve të sendeve *sipas punës që kyrejnë, sipas mjeshtërisë që veprojnë, sipas doktrinës që njekin* etj, janë formuar me prapashtesat *-ës (s), -ar, -tar, -tor, -ist* etj.; emrat e sendeve *sipas lëndës a sipas përdorimit* ose emrat e *sendeve* ku prodhehet a shitet diçka, të cilët janë formuar me prapashtesën *-or(e), tor(e)*; emrat e njerëzve sipas vendit ku banojnë të cilët janë formuar me prapashtesat: *-ar, -or, -ak, -as, -an (-jan), -it, -jot* etj.; emra *abstraktë me kuptimin e cilësisë*, të cilët janë formuar me prapashtesat, *-i, -(ë)ri, -ë(si)*; emra *abstraktë me kuptimin e veprimit*, të cilët janë formuar me prapashtesat *-im, -je*; emrat me *kuptim zvogëlimi a përkëdhelie*, që janë formuar me prapashtesash *-th, -zë*, si zogth, zëth etj.

### **Në mbiemrat:**

Mbiemat *me kuptim vepror, me kuptimin e tiparit të vepruesit* janë formuar me prapashtesën *-(ë)s*; mbiemrat *me kuptim përkatësie*, që janë formuar me prapashtesat *-ar, -tar, -or, -tor, -ian, -osh*; mbiemrat *me nunacë keqësuese, sharëse, përbuzëse, tallëse*, që janë formuar me prapashtesat *-ak, -ac (-acak, -arak, -alak, -atak), -uc, acuk, -aq, -uq, -ash, -ec (-alash, -alash, -alash, -alac)* etj.; mbiemra *me kuptimin e mundësisë së një veprimi* ose *me kuptime tjera*, që janë formuar me prapashtesën *-shëm*; mbiemrat *me kuptimin e tiparit sipas lëndës*, ose *me kuptime*

tjera, që formohen me prapashtesën –t(ë). Në formimin e këtyre mbiemrave të dy grupeve të fundit ka marrë pjesë edhe nyja e përparme.

### **Në foljet:**

Foljet, *kuptimi i të cilave lidhet me kuptimin leksikor të temave prodhuese* dhe që janë formuar me prapshtesën –o *(-ro, -so, -to, zo, -llo)*; foljet *me kuptime të ndryshme*, që janë formuar me prapshtesën –os, *(-s), it*.

### **Në ndajfoljet:**

Ndajfoljet me kuptimin e mënyrës së veprimit, që janë formuar me prapashtesën –isht; ndajfoljet me kuptimin e mënyrës së veprimit, që janë formuar me prapashtesat –as, *(-azi), -thi, -çe, si: barakas, djathtas etj*“ (Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, 2002, fv. 157-160).

Prapashtesimi quhet parësor, kur prapashtesa i shtohet një fjale të parme, p.sh. dimër-or, pyll-ëzoj, dhe dytësor, kur prapashtesa i shtohet një teme të prejardhur, p.sh. pyllëz-im, kërim-tar, vendos-je, larg-im, pun-im etj. (Shqipërisë A. e., Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia I, 2002, fv. 66-67)

Fjalët e prejardhura me prapashtesat: **-ar, -ant, -as(e), -atar, -acak, -an, -ak, -arak, -al(e), -avec, -azi, -eshë, -ës, -(ë)ri, -(ë)si, -ë(sor), -e, -ë(zi), -i, -ik(e), -im, -ist, --(i)sht, --ishte, -izëm, -je, -log, -logji, -llëk, -nik, -osh, -onjës, -or, -ore, - qar, -shëm, -(tar)-e, -tor(e), -th, -ues, -ushe, -ushë, -xhi**. në prozën e Konicës:

### **Prapashtesa -ar**

„Sipas gjuhëtarëve të njohur Meyer, Jokl, Weigand, Jordan, Pascu, kjo prapashtesë e përbashkët për të gjitha gjuhët ballkanike e ka prejardhjen nga prapashtesa latinine –**arius**, që me kohë hyri në këto gjuhë. Këtë prapashtesë e ka edhe ilirishtja dhe mendohet se në shqipen mund të jetë përzier një format vendi me një të ardhur nga latinishtja.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 207)

**Bregdetar** (bregdet), **legjendar** (legjendë), **çilfigar** (çiflig), **luftar** (luftë), **gazetar** (gazetë).

### Prapashtesa **-ant**

„Me prapashtesën -ant në gjuhën shqipe gjenden pak emra, të cilët janë të motivueshëm nga tema emërore dhe foljore. Nga pikëpamja kuptimore emrat që kanë në përbërjen e tyre prapashtesën –ant janë përgjithësisht emra vepruesi.“ (Hysa, Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe, 2004, f. 195). Në prozën e Konicës kemi hasur një emër që tregon personin që merret me një mjeshtri të caktuar.

Muzik**ant** (muzikë) (SHQIPËRISË A. E., Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe, 1976, f. 407)

### Prapashtesa **-as(e)**

„Kjo prapashtesë bashkohet me tema të emrave topikë që shënojnë, qytete, krahina, fshatra etj.“ (Hysa, Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe, 2004, f. 171)

Tiran**as** (Tiranë), venedik**as(e)** (Venedik), hapt**as** (hapur), vend**as** (vend), filipinas (Filipine), zvicr**as** (Zvicër), elbasan**as** (Elbasan), fyt**as** (fytë).

### Prapashtesa - **atar**

„Kjo prapashtesë që e ka vatrën në gegërishten, del në disa emra e mbiemra. Gjithsesi kjo prapashtesë në përhapjen e sotme është e re p.sh. Bardhi me Buzukun kanë **peshkëtar**.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, fv. 211-212)

Mes**atar** (mes, mez), peshk**atar** (peshk),

### Prapashtesa **-acak**

„Kjo prapashtesë u shtohet kryesisht temave foljore, e më rrallë, temave emërore e mbiemërore. Duhet theksuar se kuptimi keqësues a pëqeshës i kësaj prapashtese është më i theksuar në formimet nga temat foljore.“ (Hysa, Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe, 2004, f. 185)

Dor**acak** (dorë), end**acak** (endem), frik**acak** (frikë).

### Prapashtesa **-an**

„Kjo prapashtesë bashkohet kryesisht vetëm me tema emërore, rregullisht me tema të emrave topikë që shënojnë shtete, qytete a fshatra. Një numër emrash që tregojnë banorin e një vendi, kontinenti, krahine, shteti a qyteti kanë si tema fjalëformuese emra shtetesh a qytetesh të huaja.“ (Hysa, Formimi i emrave me ndajshesa në gjuhën shqipe, 2004, f. 170). „Te kjo prapashtesë e shqipes gjan të jetë bashkuar disa prapashtesa, një format –an i vendit me formate të hyra së jashtmi (sllave e latino-romane).“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 202)

**Italian** (Itali), **tunizian** (Tunizi), **algerian** (Algjeri), **afrikan** (Afrikë),

**Prapashtesa -ak**

„Edhe prapashtesa –ak ka formuar emra që shënojnë banorin e një vendi, të një krahine a qyteti.“ (Hysa, Formimi i emrave me ndajshesa në gjuhën shqipe, 2004, f. 172). Çabej në librin *Studime gjuhësore III* f.198 thotë se kjo prapashtesë u ngjitet emrave dhe mbiemrave, duke u dhënë kuptime të ndryshme.

**Ushtarak** (ushtar), **perandorak**(perandor), **fshatarak** (fshatar), **dhelparak** (dhelpër), **austriak** (Austri), **rrumbullak** (rrumbull), **gjysmak** (gjysmë) **shtëpiak** (shtëpi).

**Prapashtesa -arak**

„Me prapashtesën –arak, që është një konglutinant i prapashtesave –ar dhe –ak e pjesërisht një variacion fonetik i –ër-ak-ut, janë formuar, emra njerëzish, shtazësh dhe gjërash konkrete prej emrash e foljes, emra topikë dhe emra banorësh, mbiemra që shpesh janë pejorativ.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 207)

**Qesharak** (qesh)

**Prapashtesa -al(e)**

„Kjo prapashtesë fomon emra e mbiemra, të cilët kanë një cilësi që i afrohet fjalës rrënjë.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 199)

**Gjenial** (gjeni), **natyrale** (natyrë).

**Prapashtesa -avec**

„Me këtë prapashtesë janë formuar pak emra me kuptim pejorativ. Kjo prapashtesë, e përhapur më fort në toskërishten lindore, rrjedh nga bullgarishja **-avec**, si ligavec, që i përgjigjet serbokroatishtes **-avac**, si buravac (lloj zogu) etj. Në shqipe ka hyrë nëpërmjet fjalësh sllave, duke u bërë produktive edhe në fjalë shqipe.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 213)

Grindavec (grindem)

Prapashtesa **-azi**

„Prapashtesa **-azi** është variant i prapshtesës **-as**, me të cilën formohen ndajfolje.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 208)

Feshurazi (fshehur), prerazi (prerë), ngultazi (ngultas).

Prapashtesa **-eshë**

„Prapashtesa **-eshë** është e vjetër meqë haset që te Buzuku, si te fjala **mikeshë**. Përgjithësisht mirret si si refleks i prapashtesës latine **-issa**, e cila ka hyrë edhe në greqishten e re. Me këtë prapashtesë janë formuar prej emrash emra mocioni (nomina motions), d.m.th. emra femërorë.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, fv. 225-226)

Mbretëreshë (nga mbretëra mbretën), mikeshë (mik), konteshë (kont).

Prapashtesa **-ës**

Sipas Çabejt me prapshtesën **-ës** formohen emra e mbiemra prej foljesh, me kuptime të ndryshme. Për prejardhjen e kësaj prapashtese dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme, por Çabej si më të drejtë e quan mendimin e N. Joklit i cili prapashtesën **-s** e, me të cilin thotë, formohen emra vepronjës (nomina agentis) dhe të origjinës (etnika), e barazon me **-as** dhe e nxjerr nga **et-io**, që është një zgjerim i prapashtesës **-te** dhe që duket te fjala ilire **tergatio** (tregës). (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, fv. 230-231)

grabitës (grabit), humbës (humb), tërheqës (tërheq), bindës (bind), shpikës (shpik), shitës (shit), folës (flas), tallës (tall), nxënës (nxë), traditës (traditë), bandës (bandë), gjykatës (gjykatë), kositës (kosit), mbrojtës (mbroj), vrasës (vras), udhëheqës (udhëheq), përqeshës (përqesh), prishës (prish), urrejtës (urrej), prijës (prij).

### Prapashtesa **-(ë)ri**

Sipas Çabejt prapashtesa **-(ë)ri** formon emra femërorë (abstraktë e kolektivë). (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 228)

djalë**ri** (djalë), besnikë**ri** (besnik), fisnikë**ri** (fisnik), filizë**ri** (filiz) bujkrobë**ri** (bujkrob), qytetë**ri** (qytet), trimë**ri** (trimnisht), gjallë**ri** (gjallë), ngjashmë**ri** (i ngjashëm), gatishmë**ri** (gati), qëndrueshmë**ri** (i qëndrueshëm), devotshmë**ri** (i devotshëm).

### Prapashtesa **-(ë)si**

„Me anën e prapashtesës **-ësi** formohen, kryesisht prej mbiemrash dhe emrash dhe më pak prej foljesh, ndajfoljesh e përemrash, emra femërorë që tregojnë një veçori ose cilësi abstrakte.“ (Shqipërisë A. e., Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia I, 2002, f. 139)

Largë**si** (larg), bardhë**si** (i bardhë), bimë**si** (bimë), çiltër**si** (i çiltër), gjerë**si** (i gjerë), oborrë**si** (oborr), mjekë**si** (mjek), armiqë**si** (armiq), kënaqë**si** (kënaqem), shqiptarë**si**, (shqiptar), vështirë**si**, (i vështirë), plotë**si** (i plotë), robotë**si** (robot), egër**si** (i egër), miqë**si** (miq), butë**si** (i butë), ftohtë**si** (i ftohtë), rëndë**si** (i rëndë), rastë**si** (rast), hollë**si** (i hollë), zotë**si** (zot), gjallë**si** (i gjallë), zemërligë**si** (zemërlig), fatbardhë**si** (fatbardhë), gjakftohtë**si** (gjakftohtë), mendjelehtë**si** (mendjelehtë), kryenaltë**si** (kryenalt), marrë**si** (i marrë), urtë**si** (i urtë), udhëheqë**si** (udhëheq), kombë**si** (komb), mundë**si** (mund), zgjuarë**si** (i zgjuar), shkurtë**si** (i shkurtë), shpirtmadhë**si** (shpirtmadh), lashtë**si** (i lashtë), brendë**si** (brenda), mirë**si** (i mirë).

### Prapashtesa **-ë (sor),-e**

„Me këtë prapashtesë formohen emra vepronjësi (nomina agentis) mashkullorë e femërorë dhe mbiemra.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 233)

Thelbësore (thelb), gjuhësore (gjuhë)

### Prapashtesa **-ë(zi)**

„Kjo prapashtesë është bërë produktive në pak emra femërorë abstraktë.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 233)

Djallë**zi** (djallë)

## Prapashtesa -i

„Prapashtesa –i është një prapashtesë e vjetër në gjuhën shqipe. Sipas mendimit të H. Pedersenit dhe N. Joklit, që gjendet që te F. Boppi, prapashtesa –i është origjinale në shqipe, sepse lidhet me indoevropianishten –ija, nga e cila u reduktua e doli –ijë e pastaj u bë –i.“ (Hysa, Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe, 2004, f. 134)

Dhelpër-i, udhëheqës-i, perandor-i.

## Prapashtesa -ik(e)

„Me këtë prapashtesë formohen pak mbiemra e mbiemra të substantivuar, prej emrash e foljesh. Shumë fjalë të gjuhës popullore, që mbarojnë me –ik, janë të huaja, latino-romane ose turke. Në gjuhë të shkrimit ka hyrë, kryesisht nga gjuhët moderne, një varg i madh fjalësh me –ik..“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, fv. 238-239)

Gjermanik(e), italik, piktorik-e, enigmatik, makiavelike, ritmike, hieratike, simolike, diplomatik, daktilografike, monarkike, aziatike, gjeologjike, fisnike, arkeologjik, heroik, islamik, ironik, fotografike, akademike, romantike, magjike, dogmatike, pijanik, filologjike, artistike, anemik, alfabetik, numerike, melankolike, tragjik.

## Prapashtesa -im

Në *Gramatika e gjuhës shqipe* I f.140 thuhet se prapashtesa -im bashkohet me temën e kohës së tashme të foljeve me –oj dhe ej. Me anë të kësaj prapashtese formohen emra veprimi të gjinisë mashkullore.

Përjetim (përjetoj), përjashtim (përjashtoj), zbukurim (zbukuroj), mallëngjim (mallëngjej), adhurim (adhuroj), mbarim (mbaroj), krishtërim (gjithë të krishterë), largim (largoj), përkufizim (përkufizoj), emërtim (emëroj), përparim (përparoj), zhvillim (zhvilloj), pakësim (pakësoj), zemërim (zemëroj), pengim (pengoj), guxim (guxoj), shtrëngim (shtrëngoj), dëshpërim (dëshpëroj), tërbim (tërboj), udhëtim (udhëtoj), shkrim (shkruaj), bashkim (bashkoj), argëtim (argëtoj), pohim (pohoj), përfitim, (përfitoj), urdhërim (urdhëroj), mashtrim (mashtroj), krahasim (krahasoj), dyshim (dyshoj), shpjegim (shpjegoj), fjalim (fjalë), ilustrim (ilustroj), kundërshtim (kundërshtoj), premtim (premtoj), kurorëzim (kurorëztoj), besim (besoj), lëvdim



(lëvdoj), proponim (propozoj), mësim (mësoj), mbretërim (mbretëroj), fluturim (fluturoj), gjykim (gjykoj), shkëlqim (shkëlqej), nderim (nderoj), shpërblim (shpërblej), dëfrim (dëfrej), shentërim (shentëroj), kremtim (kremtoj), bashkim (bashkoj), adhurim (adhuroj), mundim (mundoj), kuptim (kuptoj), ndërrim (ndërroj), fitim (fitoj), ndryshim (ndryshoj), grupim (grupoj), strehim (strehoj), vështrim (vështroj), shqyrtim (shqyrtoj), kufizim (kufizoj), uzurpim (uzurpoj), gabim (gaboj), dënim (dënoj), qëndrim (qëndroj), mendim (mendoj), burim (buroj), gatim (gatuaj), ndikim (ndikoj), fabrikim (fabrikoj), teprim (teproj), luftim (luftoj), sundim (sundoj), regjistrim (regjistroj), fillim (filloj), zëvendësim (zëvendësoj), zgjerim (zgjeroj), hipnotizim (hipnotizoj), dëbim (dëboj), ilustrim (ilustroj), sugjerim (sugjeroj), shërim (shëroj), provokim (provokoj), diskriminim (diskriminoj), njerëzim (njerëz), lartësim (lartësoj), shkëmbim (shkëmbej), zaptim (zaptoj), hetim (hetoj), shërim (shëroj), shpejtim (shpejtoj), protestim (protestoj), dërgim (dërgoj), botim (botoj), qëndrim (qëndroj), pasqyrim (pasqyroj), komunikim (komunikoj), lundrim (lundroj), shpërdorim (shpërdor), mishërim (mishëroj), rrjedhim (rrjedhoj), pushtim (pushtoj), keqpërdorim (keqpërdor), veprim (veproj), pretendim (pretendoj), shformim (shformoj), izolim (izoloj), kompensim (kompensoj).

#### Prapashtesa **-ist**

„Prapashtesa **-ist** është bërë prodhimtare në gjuhën shqipe. Me anën e kësaj prapashtese prej temash emërore formohen emra që tregojnë veta të karakterizuara sipas mjeshtërisë që ushtrojnë, ose punës që kryejnë. Me anën e prapashtesës **-ist** formohen edhe emra idhtarësh të një rryme a dukurie.“ (Shqipërisë A. e., Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia I, 2002, f. 135)

Individual**ist** (individual), artist (art), ego**ist** (ego), ideal**ist** (ideal).

#### Prapashtesa **-(i)sht, --ishte**

„Me këtë prapashtesë janë formuar ndajfolje mënyre prej emrash e mbiemrash.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 246)

Zakon**isht**, individual**isht**, baraz**isht**, pikërisht, praktik**isht**, tërë**isht**, detyrim**isht**, fillim**isht**, pjesërisht, afërsisht, përfundim**isht**, përkatës**isht**, plotës**isht**, greq**isht**, hebra**isht**, gjerman**isht**, gabim**isht**, rrjedhim**isht**, madhërisht, kryes**isht**, italisht, financialisht, paralelisht, keltishte, fizikisht, latinisht, botërisht, personalisht, lirisht, krejtësisht, individualisht,

njëkohësisht, aktualisht, indisht, hebraisht, natyrisht, rrjedhimisht, pjesërisht, politikisht, gjerësisht, bashkërisht, verbërisht, çuditërisht, fizikisht, seriozisht, ilirisht, përgjithësisht, tërësisht, afërsisht.

#### Prapashtesa - **izëm**

Me anë të kësaj prapashtese sipas Enver Hysës në librin *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, f.195 formohen emra abstraktë që shënojnë një sistem të caktuar shoqëror ose një rrymë ideologjike.

Imperializëm (imperial), heroizëm (hero), myslimanizëm (mysliman), skepticizëm (skeptik), bizantinizëm (bizantin).

#### Prapashtesa -**je**

„Me anë të prapashtesës **-je** formohen emra veprimi të gjinisë femërore. Prapashtesa **-je** bashkohet me temën e pjesores së foljeve që mbarojnë me bashkëtingëllore, me pjesoren e foljeve më **-iej, -yej, -y, -ij**, me atë të foljeve të parregullta, si edhe me pjesoren e foljeve më – uaj.“ (Shqipërisë A. e., Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia I, 2002, f. 141)

Hamendje (hamendem), gjendje (gjendem), prejardhje (prejardhur), mbledhje (mbledhje), zhdukje (zhduk), mburrje (mburr), shpifje (shpif), shpikje (shpik), stërvitje (stërvit), përbuzje (përbuz), mendje (mend), shfaqje (shfaq), puthje (puth), tërheqje (tërheq), vjeshje (vesh), përlëshje (përlësh), shprehje (shpreh), heshtje (hesht), dërdëllisje (dërdëllis), dukje (duket), pamje (shoh, parë), mbështjellje (mbështjell), rrojtje (rroj), paraqitje (paraqitem), udhëheqje (udhëheq), ndarje (ndaj, ndarë), blerje (blej, blerë), lidhje (lidh), ndrojtje (ndruaj), lutje (lus), përshtatje (përshtat), zgjedhje (zgjedh), urrejtje (urrej), lëvizje (lëviz), qorollisje (qorollis), habitje (habit), ngjitje (ngjitem), përmbledhje (përmbledh), përputhje (përputh), përndjekje (përndjek), përkrahje (përkrah), përshtatje (përshtat), derdhje (derdh), sharje (shaj, sharë), falënderje (falënderoj), shëtitje (shëtitis), tallje (tall), vjedhje (vjedh), shtytje (shtyt, shtytur), mbrojtje (mbroj), goditje (godit), fanepsje (faneps), pjekje (pjek), syrgjynosje (syrgjynos).

#### Prapashtesa - **log,-logji**

„Në grupin e siprapashtesave si kategori mjetesh fjalëfomruese përfshihen zakonisht – **grafi, -graf, -log, -logj dhe –fil**, të cilat në një farë mënyre mund të shihen si ndërkombëtarizma. Me të në gjuhën shqipe dalin një numër emrash që shënojnë zakonisht një fushë të veçantë të veprimtarisë kërkimore, ose studiuesin që merret me një dije të caktuar.“ (Hysa, Formimi i emrave me ndajshesa në gjuhën shqipe, 2004, f. 201)

etnolog-etno+**log**, fililolog=filo+**log**, **fiziologji=fizio-logji**, biologji=bio-**logji**, psiko-**logji**, termino-**logji**.

#### Prapashtesa **-llëk**

„Ndërmjet prapashtesave të huaja, Enver Hysa në librin, *Formimi i emrave me ndajshesa në gjuhën shqipe*, thotë e se një vend të veçantë zë edhe prapashtesa –llëk me burim nga turqishtja, e cila gjendet në një numër të madh fjalësh të huazuara nga turqishtja, por edhe në një numër temash të fjalëve të tjera.“ (Hysa, Formimi i emrave me ndajshesa në gjuhën shqipe, 2004, f. 199)

Fodull**ëk** (fodull), budallall**ëk** (budalla).

#### Prapashtesa **-nik**

„Me këtë prapashtesë janë formuar emra dhe mbiemra prej emrash, mbiemrash, foljesh e ndajfoljesh, duke shënuar një gjë konkrete ose cilësi. Së pari kjo prapashtesë ka hyrë në shqipe prej emrash sllavë si gallnik, çaranik etj.; pastaj është bërë produktive edhe në fjalë shqipe si fisnik, besnik etj.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 258)

Thatan**ik** (i thatë), verdhan**ik** (i verdhë), fisn**ik** (fis).

#### Prapashtesa **-osh**

„Me prapashtesën **-osh** janë formuar në gjuhën shqipe pak emra.“ (Hysa, Formimi i emrave me ndajshesa në gjuhën shqipe, 2004, f. 189) „Sipas Joklit kjo prapashtesë, e shpeshtë në shqipet, shënon pjesërisht personin që zotëron si cilësi atë që tregon fjala primitive, pjesërisht përdoret për formim pejorativësh; por në disa fjalë e ka humbur funksionin e saj specifik, si te **djalosh, Gjelosh**.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 268)

**Djalosh** (djalë)

**Prapashtesa - onjës**

„Me anë të prapashtesës –onjës formohen emra veprues (nomina agentis) e ndonjë mbiemër.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 264)

**Mësonjës** (mësoj), **zhurmonjës** (zhurmë), **botonjës** (botoj), **shkronjës** (shkronjë), **rregullonjës** (rregulloj), **përfaqësonjës** (përfaqësoj), **kënonjës** (këndo), **imitonjës** (imitoj), **kundërshtonjës** (kundërshtoj), **shikonjës** (shikoj), **menonjës** (mendoj), **kërkojnës** (kërkoj), **dëftonjës** (dëftoj), **vëzhgonjës** (vëzhgoj), **shëronjës** (shëroj), **lëftonjës** (luftoj), **qëndronjës** (qëndroj), **pajtonjës** (pajtoj).

**Prapashtesa - or**

„Me prapashtesë –or formohen emra prej emrash dhe mbiemra. Prapashtesa -or është bërë shumë produktive në gjuhë të shkrimit, duke formuar me të emra.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 265)

**Shekullor** (shekull), **ligjor** (ligj), **madhështor** (madhështi), **popullor** (popull), **qendror** (qëndër), **fëmijëror** (fëmijë), **lakror** (lakër), **ambasador** (ambasadë), **shtazor** (shtazë), **kulturor** (kulturë), **themelor** (themel), **miqësor** (miqësi), **fjalor** (fjalë), **malësor** (malësi), **racor** (racë).

**Prapashtesa -ore**

„Prapashtesa –ore u shtohet temave emërore e më rrallë atyre foljore e mbiemërore.“ (Shqipërisë A. e., Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia I, 2002, f. 137) „Disa nga fjalët e formuara me –ore që tregojnë vendin ose veglën kanë kuptim zvogëlimi.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 266)

**malore** (mal), **bregore** (breg), **trimërore** (trimëri), **engjëllore** (engjëll), **shpirtërore** (shpirt), **rregullore** (rregull), **shëndetore** (shëndet), **kodrinore** (kodrinë), **popullore** (popull), **muskulore** (muskul), **gojore** (gojë), **femërore** (femër), **fushore** (fushë), **pjellore** (pjellë), **shkencore** (shkencë), **statistikore** (statistikë), **themelore** (themel), **muzikore** (muzikë), **perëndimore** (perëndim), **shëmbëllore** (shëmbëll), **arbënore** (arbën), **mendore** (mend),

mjekësore (mjekësi), njerëzore (njerëz), prindërore (prindër), ndëshkimore (ndëshkim), popullore (popull), zakonore (zakon), jugore (jug), skajore (skaj), shtatore (shtat).

#### Prapashtesa **-qar**

„Kjo prapashtesë, marrë prej turqishtes, formon mbiemra që kanë si cilësi atë që tregon primitivi, dhe ka hyrë në gjuhë bashkë me fjalët turke, p.sh gjyhnaqar etj.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 270)

#### Zili**qar** (zili).

#### Prapashtesa **-shëm**

„Me këtë prapashtesë janë formuar prej emrash, folje e ndajfolje mbiemrash, që tregojnë një cilësi të rrjedhur nga të pajisurit me një gjë ose me një veti. Sa për burimin e kësaj prapashtese pak gjasë ka më në fund mendimi i Bariçit që **-shëm** të jetë formuar brenda shqipes nga një bashkimi i prapashtesës **-sh** me prapashtesën **-m**.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, fv. 272-274)

I dobishëm (dobi), i mëshirshëm (mëshirë), i shpjegueshëm (shpjegim), i çmueshëm (i çmuar), të gatshëm (gati), i kujdesshëm (kujdes), të qëndrueshëm (qëndroj), i fuqishëm (fuqi), i ngadalshëm (ngadalë), i tmerrshëm (tmerr), i çuditshëm (çudi), të guximshëm (guxim), i mjaftueshëm (mjaftue), i hollësisshëm (hollësi), të shëndetshëm (shëndet), i arsyeshëm (arsye), i mistershëm (mister), rregullshëm (rregull), i famshëm (famë), i lavdishëm (lavdi), i levërdishëm (levërdi), i mirësjellshëm (mirësjellje), i brendshëm (brenda).

#### Prapashtesa **-tar (e)**

„Kjo prapashtesë në gjuhën shqipe ka formuar një numër të shumtë emrash nga tema fjalëfomuese të ndryshme. Ajo në gjuhën shqipe del që te autorët e vjetër, që te Buzuku. Kjo prapashtesë, e cila në gjuhën shqipe është bërë shumë prodhimtare, sidomos në gjuhën e shkrimit, për të formuar emra vepruesi ose me emra me kuptime të tjera, bashkohet kryesisht me tema emërore të parme ose të prejardhura dhe më rrallë me tema të tjera.“ (Hysa, Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe, 2004, f. 162)

kombëtare (komb), shqiptar (shqip), kryetar (krye), atdhetar (atdhe), qeveritar (qeveri), zyrtare (zyrë), anëtar (anë), themeltare (themel), udhëtar (udhë), fetare (fe), shpëtimtare (shpëtim), ndihmestare (ndihmesë), amëtar (amë), dëshmitar (dëshmi), tregtar (treg), mesdhetar (e)- (mesdhe), shkatërrimtar-e (shkatërrim), ngadhënjimtar (ngadhënjim), trashëgimtar (trashëgim), përfundimtar-e (përfundim), kalimtar-e (kalim), gojëtar (gojë), përparimtare (përparim), gjellëtar (gjellë), shqiptar-e (shqip), sundimtar (sundim), qeveritar (qeveri), vendimtar (vendim), gjuhëtar (gjuhë), mesjetare (mesjetë), shkrimtar (shkrim).

#### Prapashtesa **-tor(e)**

„Me këtë prapashtesë, e cila duke u zbërthyer del në trajtat –tuar toskërisht e –tuer gegërisht, janë formuar, prej emrash më tepër, emra vepronjës, dhe disa pak mbiemra. Sa për gurën e kësaj prapashtese, Boppi e krahason me indoevropianishten e vjetër **–tar**, lat-**tor**.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 281)

Vjershëtor (vjershë), punëtor (punë), baritor-e (bari)

#### Prapashtesa **-th**

Me këtë prapashtesë formohen më së fortë emra mashkullorë zvogëlimi prej emrash zakonisht mashkullorë, si dhe disa mbiemra e ndajfolje prej fjalësh tjera. (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 283)

#### Flamurth

#### Prapashtesa **-ues**

Kjo prapashtesë formon një kategori të pasur emrash veprues (nomina agentis), ka dhe mbiemra të substanvinuar. Në gjuhë të shkrimit mbizotëron kjo trajtë e gegërishtes, që në shumë rase është përgjithësuar në gjuhë. (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, f. 286)

Gjallërues (gjallëroj), shkatërrues (shkatërroj), kërkues (kërkoj), mbizotërues (mbizotëroj), ngulmues (ngulmoj), kërcënues (kërcënoj), gjarpërues (gjarpëroj), ndërtesues (ndërtoj), përfaqësues (përfaqësoj), dhunues (dhunoj), vëzhgues (vëzhgoj), sulmues (sulmoj), studiues (studioj), pushtues (pushtoj), konservues (konservoj), imponues (imponoj), drejtues

(drejtoj), komentues (komentoj), informues (informoj), lexues (lexoj), depërtues (depërtoj), lehtësues (lehtësoj), sfidues (sfidoj), themelues (themeloj).

Prapashtesa **-ushe**

„Në **-ushe** dalin në gjuhën shqipe emri brekushe nga tema emërore brekë dhe barkushe nga bark, që të dy emra me kuptim të kundërt.“ (Hysa, Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe, 2004, f. 188)

Brekushe (brekë)

Prapashtesa **-ushë**

„Me këtë prapashtesë janë formuar emra mashkullorë e femërorë prej emrash, disa me kuptim zvogëlimi a përkëdhelie, dhe mbiemra prej mbiemrash. Sa për shqipen, ka shumë të ngjarë që të kemi të bëjmë me një prapashtesë vendi të lashtë, që na del n’ilirishtet, si te emri i lumit **Genusus**, te emri topik **Marusio** dhe në emra personazhesh **Ebusius** etj.“ (Çabej, Studime gjuhësore III, 1987, fv. 293-294)

Zonjushë (zonjë).

Prapashtesa **-xhi**

„Prapashtesa **-xhi** me burim nga turqishtja, e cila gjendet në një numër të madh fjalësh të huazuara nga turqishtja, por edhe në një numër të temash të fjalëve të tjera.“ (Hysa, Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe, 2004, f. 199)

Han**xhi** (han), kumar**xhi** (kumar), saz**xhi** (saze), kallaj**xhi** (kallaj), dallaver**xhi** (dallavere), dyqan**xhi** (dyqan).

### 3.3 Prejardhja me parashtesim e prapashtesim njëkohësisht

Ka edhe disa fjalë që formohen me parashtesa dhe prapashtesa njëkohësisht. (Z. Osmani, F. Bojku, 2010, f. 190).

„Tipat e formimit të fjalëve njëkohësisht me parashtesë dhe prapashtesë janë më pak produktivë sesa formimet vetëm me parashtesë ose vetëm me prapashtesë, por këta tipa janë mjaftë aktivë në shqipen e sotme letrare, sidomos në stilin libror.“ (Gjuha shqipe për të gjithë Gramatikë e gjuhës shqipe, 2019)

„Në këtë rast si parashtesa ashtu edhe prapashtesa i shtohen në të njëjtën kohë dhe drejtpëdrejt temës fjalëformuese. Në mënyrë paraktike lidhjen e menjëhershme të ndajshesave me temën fjalëformuese e vërtetojmë duke hequr njëherë parashtesën dhe më pastaj prapashtesën. Në të dyja rastet nuk na mbetet një temë e gjallë në gjuhën shqipe. Për shembull, për foljen *zbukuroj* nuk ka pasur një temë fjalëformuese të ndërmjetme – **bukuroj**, as **zbukur-**, prandaj themi se folja *zbukuroj* nuk formohet as nga **z+bukuroj**, as nga **zbukur+o+j**. Në këtë tip hyjnë edhe disa fjalë që historikisht janë formuar me përngjitjen e një sintagme dhe me prapashtesim, porse në gjendjen e sotme të gjuhës shqipe, pjesa e parë e sintagmës ndihet si parashtesë p.sh **nëndetëse (nën det+ëse)**, **përjetësi (për jetë+ësi)** etj. Gjithashtu në këtë tip futen edhe ato fjalë , për formimin e të cilave, veç parashtesës dhe prapashtesës, ka shërbyer edhe nyja e përparme e mbiemrave, si i **përjavshëm (i+për+javë+shëm)** etj.“ (Universiteti „ S., 1998, f. 132)

„Formimet parashteso-prapashtesore duhen dalluar nga formimet e përfituara me anë të prapashtesimit të një togu parafjalë+emër, si pagjumësi (pa+gjumë+si), pafundësi (pa fund+ësi), nëpunës (n punë+s), mëditje (më ditë+je) etj. Nga pikëpamja e përbërjes strukturore këto fjalë janë krejt njësoj me formimet parashteso-prapashtesore, por mënyra e formimit, motivimi i tyre, shihet qartë se janë të ndryshëm. Shembujt e mësipërm janë formuar me përngjitje dhe prapashtesim. Sidoqoftë dallimi i këtyre formimeve nuk është gjithnjë aq i prerë. Kategoria e dytë me kohë kalon në të parën (p.sh. përvetësoj nga vete + prapashtesën –so-j).“ (Shqipërisë A. e., Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia I, 2002, f. 68)

Fjalët e prejardhura me parashteso-prapashtesim në prozën e Konicës:

**z+bukur+onj**= *zbukuronj*, **për+fytyr+o(j)**=*përfytyroj*, **i për+shtat+shëm**= *i përshtatshëm*, **i për+gjith+shëm**=*i përgjithshëm*, të **për+pik+të**= të *përpiktë*, e **për+bashk+ët**=*e përbashkët*, e **për+cip+të**= *e përciptë*, **përpikërisht**=**për+pikë+risht**, e **përzemërt**= **për+zemër+t**, **përkrah(-)**, **përbuz(-)**, **përdor(-)**, **përmbys(-)**.





## IV. KOMPOZIMI

Fjalët e përbëra (kompozitat) ndërtohen nga bashkimi i dy fjalëve emërtuese pa mbaresa. (M. Çeliku, M Karapinjalli, R. Stringa, 2011, f. 366). „Kompozimi është një mënyrë fjalëformimi me anë të së cilës krijohen fjalë të reja që kanë në përbërjen e tyre dy a më shumë tema motivuese; njëra nga këto (tema mbështetëse, që është zakonisht e dyta) e formëson gramatikisht gjithë kompozitën, ndërsa tema tjetër (ose temat e tjera, kur janë më shumë se një) është e asnjansuar nga pikëpamja e kuptimeve të saj gramatikore.“ (SHQIPËRISË A. E., 1995, f. 70).

„Fjalët e përbëra janë formuar nga bashkimi i dy ose më shumë temave gjatë krijimit të fjalëve të reja. Pjesët e tyre mund të jenë tema emërore, mbiemërore, foljore ose ndajfoljore, si: zemërgur, belhollë, buzëqesh, keqkuptoj, fjalëshumë etj. Marrëdhëniet ndërmjet këtyre temave janë të ndyshme. Në disa fjalë të përbëra gjymtyrët janë të barasvlershme dhe përcaktojnë njësoj njëra-tjetrën. Këto janë *fjalë të përbëra të bashkërenditura*, si: *vajtje-ardhje*, *marrëdhënie*, *veshmbathje* etj. Ato janë quajtur edhe fjalë të përbëra lidhëzore (kopulative), sepse shtjellohen në togje lidhëzore, si: *vajtje-ardhje* „vajtje dhe ardhje“, *shitblerje* „shitje dhe blerje“.

Më të shumta janë fjalët e përbëra, te të cilat njëra gjymtyrë përcakton tjetrën, njëra është e përcaktuar dhe tjetra përcaktuese. Te *kryeqytet* „qytet i kreut“, *mëmëdhe* „dheu mëmë“, *mirëmbaj* „mbaj mirë“, keqpërdor „përdor keq“ është gjymtyra e parë që e përcakton të dytën, kurse te zemërçelur „që e ka zemër të çelur“, *kokëshkëmb* „që e ka kokën të fortë si shkëmbi“ etj. gjymtyra e dytë përcakton të parën.“ (Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, 2002, f. 165)

„Pas ndajshitesimit kompozimi është mënyra më prodhimtare e formimit të fjalëve në shqipen e sotme. Kompozita duke pasur të paktën dy tema motivuese. Kanë zakonisht një ngarkesë semantike më të madhe se fjalët e prejardhura dhe e praqesin më qartë më qartë e në mënyrë të drejtpërdrejtë nocionin që shprehin, prandaj ata marrin përhapje të gjerë, sidomos në terminologjinë tekniko-shkencore, ku kërkohet një shprehje sa më e përpiktë dhe njëkohësisht sa më ekonomike e koncepteve, p.sh. *farëveshur*, *farëzhveshur*, *baraslargesë*, *i bashkëmatshëm*,

*brendashkruaj, frymëmarrje, sipërfaqe, drejtvendosje, gjysmëhije, i tejdukshëm, vetëpjalnim, lartësimatës etj.*“ (Shqipërisë A. e., Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia I, 2002, f. 70)

„Fjalët e përbëra, sidomos nëpër gramatikat, i kanë grupuar edhe sipas vlerës leksiko-gramatikore: *emërore (frymëmarrje, kryengritje, kokçarje, mikpritje, botëkuptim, armëpushim etj.); mbiemërore (syshkruar, kurrizdalë, shpatullgjerë, këmbëshpejtë, mendjendritur, hundëshqiponjë, veshgjatëetj.); foljore (mirëpres, mirëmbaj, keqpërdor, keqkuptoj, buzëqesh, duartrokit etj.); ndajfoljore (krahëhapur, duarkryq, këmekryq, duarlidhur etj.)*. Fjalët e përbëra grupohen gjithashtu edhe nga ndërtimi, sipas vlerës leksiko-gramatikore të gjymtyrëve, si: *emër+emër (juglindje, kryeministër, kokëderr etj.), emër+mbiemër (shtathedhur, zemërmirë etj.)*. Ky grupim formal është i lehtë dhe mund të bëhet sa herë që ndeshemi me fjalë të përbëra në mësimin e gjuhës, sepse ndriçon kuptimin e njësisë në tërësi.“ (Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, 2002, f. 165)

Sami Frashëri kompozitat i quan mbiemra të ngjitur dhe thotë se ato bëhen prej një emri dhe mbiemri ose prej dy emrash. Këta s’ marrin kurrë nyje. Femërorja e atyre që janë të përbërë prej dy emrash bëhet sikur të ishte pjesa e dytë mbiemër, si: *zemër-gur, zemër-gure; hundë-dash, hundë-dashe*. (Frashëri, 1979, f. 85)

„Kompozitat përcaktore luajnë një rol të rëndësishëm për pasurimin e fjalorit, pasi ato shërbejnë edhe si tema fjalëformuese, p.sh: *kryeqytet-kryeqytetas, bregdet-bregdetar, gjaknxehtë-gjaknxehtësi, fatkeq-fatkeqësi etj.* Por fjalët e prejardhura prej tyre, që quhen ndryshe edhe kompozita të rreme, duhen dalluar nga kompozita e mirëfillta. Ato nga pikëpamja strukturore janë vërtetë fjalë të përbëra, kanë dy morfema rrënjore, por nga pikëpamja e fjalëformimit janë fjalë të prejardhura me prapashtesim: *kryeqytetas* motivohet nga *kryeqytet* (banor i kryeqytetit) dhe jo nga *kye* e *qytetas*.“ (Shqipërisë A. e., Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia I, 2002, f. 73)

Në prozën e Konicës kemi hasur disa fjalë që nga përbërja strukturore janë fjalë të përbëra dhe përbëhen nga dy morfema rrënjore siç janë fjalët: **zemërligësi, fatbardhësi, gjakftohtësi, mendjelehtësi, bujkrobëri, kryenaltësi, udhëheqësi, shpirtmadhësi, udhëheqës**, por ne këta do t’i grupojmë te fjalët e prejardhura për shkak se në aspektin e fjalëformimit është

shumë e qartë se këta fjalë janë të prejdardhura me prapashtesim dhe ndryshe quhen kompozita të rreme.

Kompozitat që janë gjetur në prozën e Konicës:

#### 4.1 Kompozita përcaktore sipas ndërtimit:

##### Emër +emër

Morrvrasës=morr+vrasës, gjakpirës=gjak+pirës, kryeqytet=krye+qytet, syçakaj=sy+çakaj, kryeshenja=krye+shenja, kryevepra =krye+vepra, kryekonsull=krye+konsull, kryeplak=krye+plak, kryeministër=krye+ministër, bregdet=breg+det, punëdhënës=punë+dhënës, taksambledhës=taksa+mbledhës, gjakmarrja-gjak+marrja, gjysmanalfabet=gjysm+analfabet, gjysmëkafsh=gjysmë+kafsh, gjysmëtasagjysmë+tasa, vargmal=varg+mal, këmekryq=këmbë+kryq, gjysmëfeudalgjysmë+feudal, kryengritës=krye+ngritës, kryepuna=krye+puna, fjalëkryq=fjalë+kryq, gjellbërësgjell+bërës, kryekomandant=krye=komandant, flamurbajtës=flamur+mbajtës, mikpritësmik+pritës, vendbanim=vend+banim, vendlindjevend+lindje, udhërrëfyes=udhë+rrëfyes, kartënxirëskartë+nxirës, hakmarrjehak+marrje, kartëmonedhakartë+monedha, dorëshkrim=dorë+shkrim, përshtypjelënësepërshtypje+lënëse, vdekjeprurësvdekje+prurës,

##### Emër +mbiemër

Kryeulur=krye+i/e ulur, kryelartë=krye+i/e lartë, trushterpatru+shterpa, zemërbardhë=zemër+i/e bardhë, gojëhapurgojë+i/e hapur, leshverdhë=lesh+i/e verdhë, mesholla=mes+i/e holla, sybardhasy+e bardha, kokëngjeshurkokë+i/e ngjeshur, kokëshkretëkokë+i/e shkretë, kokëfortëkokë+i, e fortë, derëbardhë=derë + i/e bardhë, mjegullveshurmjegull+i/e veshur, vetulltrashëvetull+trashë, fytyrrumbullak=fytyrë+rumbullak, zemërulur=zemër+i/e ulur, syhapëtsy+i/e hapët, sypatrembur=sy+i/e patrembur, syzi=sy+i zi, shtatlartë=shtat+i/e lartë, mendjelehtë=mendje+i,e lehtë, këmbëzbathur=këmbë+i zbathur.

### **Numëror/përemër i pacaktuar+emër**

shumëngjyrësh=shumë+ngjyrësh, disangjyrësh=disa+ngjyrësh.

### **Ndajfolje +emër**

mirëbërës=mirë+bërës, mbarëvajtje=mbarë+vajtje, mirësjellje=mirë+sjellje,  
bashkëvendës=bashkë+vendës, bashkudhëtar=bashkë+udhëtar, bashkatdhetar=bashkë+atdhetar, ,  
keqkuptim=keq+kuptim, keqpërdorim=keq+përdorim, mirëbesim=mirë+besim,  
hiçnjeri=hiç+njeri.

### **Emër + ndajfolje**

fuqiplot=fuqi+plot, kuptimplot=kuptim+plot, veskeq =ves+ keq, fatkeq=fat+keq,

### **Emër +përemër i pacaktuar**

gjuhëshumë=gjuhë+shumë

### **Përemër+emër**

vetëbesim=vetë+besim, vetëmbrojtje=vetë+mbrojtje, vetëqeverim=vetë+qeverim

## **4.2 Kompozita këpujore**

### **Emër+emër**

Dorëtrokitje=dorë+trokitje, buzëqeshje=buzë+qeshje, atdhe=at+dhe,  
juglindje=jug+lindje, mëmëdhe=mëmë+dhe, pendë-kallamar

### **Emër+mbiemër**

verilindore=veri+lindore, greko-romake, politik-shoqëror, /elektro-magnet

### 4.3 Grupimi i kompozitave sipas vlerës leksiko-gramatikore

**Emra:** morrvrasës, gjakpirës, kryeqytet, syçakaj, kryeshenja, kryevepra, kryekonsull, kryeplak, kryeministër, kryepuna, bregdet, punëdhënës, taksambledhës, vargamal, gjysmëfeudal, gjysmëkafsh, fjalëkryq, gjellëbërës, kryekomandant, flamurmbajtës, mikpritës, vendbanim, vendlindje, udhërryfytes, kartënxirës, hakmarrje, kartëmonedha, dorëshkrim, përshtypjelënëse, vdekjeprurës, mirëbërës, mbarëvajtje, mirësjellje, bashkëvendës, bashkudhëtar, bashkatdhetar, keqkuptim, keqpërdorim, vetëbesim, vetëqeverim, vetëmbrojtje, buzëqeshje, dorëtrokitje, atëdhe, mëmëdhe, juglindje.

**Mbiemra:** gjysmanalfabet, kryeulur, kryelartë, trushterpa, zemërbardhë, leshverdhë, mesholla, sybardha, kokëngjeshur, kokëshkretë, kokëfortë, derëbardhë, mjegullveshur, vetulltrashë, fytyrrumbullak, zemërulur, syhapët, sypatrembur, syzi, syçakaj, shtatëlartë, mendjelehtë, këmbëzbathur, fatkeq, veskeq, fuqiplot, kuptimplot, shumëngyrësh, disangjyrësh, gjuhëshumë, pendë-kallamar, verilindore, greko-romake, austro-hungareze, politiko-shoqëror.

**Ndajfolje:** këmbëkryq.

## V. NYJËZIMI

„Formimi i fjalëve të reja me anë të nyjes është një mënyrë shumë prodhimtare në gjuhën e sotme. Shumica dërrmuese e pjesoreve mund të shndërrohen në këtë rrugë në mbiemra të nyjshëm. Mbiemrat e formuar prej pjesoreve të foljeve kalimtare kanë përgjithësisht kuptim pësor, p.sh. *i hapur, i lagur, i mësuar, i shkruar etj.* (= *që është hapur, lagur etj.*), d.m.th. ruajnë kuptimin pësor të pjesores, kurse mbiemrat e formuar prej pjesoreve të foljeve jokalistare kanë në përgjithësi kuptim vepror, p.sh. *i ardhur, i fjetur, i lëvizur, i ndenjtur, i qeshur etj.* Një pjesë e këtyre pjesoreve të nyjzuar, kanë kaluar me kohë në klasën e mbiemrave, p.sh. *i ardhur (bukë e ardhur, qushmti i ardhur etj.)*.“ (Shqipërisë A. e., Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia I, 2002, f. 69)

„Nyja e përparme të mbiemrat prejpjesorë shërben edhe si format fjalëformues, edhe si shprehëse e kategorive gramatikore të rasës, gjinisë dhe numrit, pra ka një funksion të dyfishtë. Nyja e përparme është në thelb një element gramatikor dhe jo fjalëformues. Ajo fiton aftësi fjalëformuese pikërisht duke ia ndërruar përkatësinë morfologjike një klase fjalësh, siç janë pjesoret.“ (Universiteti „S.“, Gjuha shqipe për studentët, 1998, f. 133)

„Funksioni kryesor i nyjave është të shënojë kategoritë gramatikore të mbiemrave. Funksioni tjetër i nyjave është fjalëformues, sepse prania e nyjes së përparme dallon mbiemrat nga ndajfoljet dhe nga pjesoret e foljeve. Në rastin e parë, dallimi ndërmjet ndajfoljes dhe mbiemrit, që kryhet me anë të nyjes, shënon dallimin ndërmjet një gjendjeje të caktuar, të shprehur nga ndajfolja, dhe një cilësie të përhershme, të shprehur nga mbiemri. Në rastin e dytë, dallimi ndërmjet pjesoreve të foljeve dhe mbiemrave të formuar prej tyre me anë të nyjave, është dallimi ndërmjet veprimit foljor, të shprehur nga pjesorja, dhe një cilësie, të shprehur nga mbiemri.“ (Topalli, 2009, f. 179)

„Nyjzimi është një mënyrë prodhimtare edhe për formimin e emrave prejfoljorë asnjans e femërorë, si: *të ecur-it, të menduar-it etj.* Këta emra prejfoljorë asnjans ose femërorë si tip fjalëformues e kanë burimin të emërimit të mbiemrit prejpjesor përkatës në trajtën e gjinisë

asnjanëse ose femërore (njësoj si *të ritë, të zitë, të verdhët, e shkuara* etj.). Por, sot, kur sot kategoria e mbiemrave prejpjesorë asnjans është rruður mjaft, këta emra prefoljorë asnjans motivohen drejtpërdrejt nga pjesorja dhe mund të formohen lirisht prej kësaj trajte, prandaj në rrafshin sinkronik ato dë të merren si të formuar drejtpërdrejt nga nyjëzimi i pjesores e jo nga emërzimi i mbiemrave prejpjesorë asnjans a femërorë.“ (Shqipërisë A. e., 1995, f. 69)

## 5.1 Mbiemra prejpjesorë

I ngarkuar (ngarkuar) , i quajtur (quajtur), e qytetëruar (qytetëruar), e endur (endur), i kërkuar (kërkuar), i shkolluar (shkolluar), i stërvitur (stërvitur) , i zhveshur (zhveshur), i sterilizuar (streilizuar), i përqëndruar (përqëndruar), të shkëlqyer (shklqyer), i ndërtuar (ndërtuar), i rrëmbyer (rrëmbyer), i hapur (hapur), i gdhendur (gdhendur), e ngulur (ngulur), i druajtur (druajtur), i zhvilluar (zhvilluar), i poshtëruar (poshtëruar), i trashëguar (trashëguar), e ngurtësuar (ngurtësuar), i grisur (grisur), i dërsitur (dërsitur), i lodhur (lodhur), i shentëruar (shentëruar), i mbërthyer (mbërthyer), i gabuar (gabuar), i shkolluar (shkolluar).

## 5.2 Emra prefoljorë

Të lavdëruar-it, të menduar-it, të njohur-it, të ecur-it, të veshur-it, të sjellur-it, të bashkuar-it, të shikuar-it, të bler-ët, të ngrën-it, të përdorur-it, të thekur-it, të pandehur-it, të mosradhur-it, të moskuptuar-it, të lodhur-it, të hapur-it, të ndruar-it, të vetëquajtur-it, të dukur-it, të bindur-it, të liruar-it, të shkruar-it, të zhdukur-it, të rritur-it, të shtuar-it, të zgjedhur-it, të ardhurit, të qëndruar-it, të tretur-it, të vepruar-it, të prishur-it, të qëlluar-it, të ditur-it, të dërguar-it.



## VI. FORMAT E PËRZIERA

Mënyrat e fjalëformimit veprojnë shpeshherë edhe të gërshetuara me njëra-tjetrën. Më të zakonshme janë gërshetimet e mëposhtme:

**6.1. Përngjitje dhe prapashtesim.** Me këtë mënyrë formohen ndajfolje, emra; pra përngjitet një tog parafjalor ose një trajtë foljore analitike, duke marrë edhe një prapashtesë. (Shqipërisë A. e., Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia I, 1995, f. 78)

padrejtësi, paanësi, nëpunës , paburrëri

**6.2. Nyjëzim dhe prapashtesim.** Kjo mënyrë është mjaft prodhimtare në formimin e mbiemrave prej temash emërore, foljore e ndajfoljore me anë të prapashtesave –t(ë), -shëm dhe (ë)m. (Shqipërisë A. e., Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia I, 2002, f. 79)

! dobishëm, e shëndetshme, e hijshme, e çmueshme, të gatshëm, i mëshirshëm, i shpjegueshëm, i kujdesshëm, të qëndrueshëm, të fuqishme, i ngadalshëm, e tmerrshme, i çuditshëm, të guximshëm , të mjaftueshme, i hollësishtëm, , të fuqishëm, të pranishëm, e këndshme, e ardhshme, e famshme, e zakonshme, e volitshme, i artë, i argjendtë, e sipërme, të mirfilltë, të largëta, e dukshme, i hatashëm, të vëllimshme, i mprehtë, e vijueshme, i rëndësishtëm, i trashëgueshëm, të ngjashëm, i qëndrueshëm, e habitshme, e rrezikshme, të pranueshëm, i lezetshëm, të krahasueshëm-e, e dikurshme, e kundërt, të ndershme, të largme, e tepërt, i ligjshëm, e thiktë, të cekët, e perëndishme, të fundme, të sotme, i shpejtmë, të dyshimtë, i domosdoshtëm, të kushtueshme, të fitimshme, të paqme, të dhëmshme, e zorshme, i hazërtë, të tërthortë, e dukshme, i levërdishëm,

**6.3. Nyjëzim dhe parashteso-prapashtesim.** Edhe me anë të kësaj mënyre formohen mbiemra me anë të prapashtesave –t(ë), -shëm dhe (ë)m. (Shqipërisë A. e., Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia I, 2002, f. 79)

E përzemërt , i përshtatshëm, i përgjithshëm, , të përpiktë, e përbashkët, e përciptë

**6.4. Nyjëzim dhe përngjitje.** Me anë të kësaj mënyre formohen gjithashtu mbimera nga nyjëzimi i një togu parafjalor: i pashkollë (pa shkollë), i pashtëpi (pa shtëpi), i paraluftës (para luftës) etj. (Shqipërisë A. e., Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia I, 2002, f. 79)

Në prozën e Konicës janë gjetur fjalët: të pagjak (pa gjak), të pafund (pa fund), e pashoqe (pa shoqe), i pashkollë (pa shkollë).

**6.5. Kompozim dhe ndajshtesim.** Me këtë mënyrë formohen emra nga kompozimi i një togëfjalëshi frazeologjik, të cilit i shtohet një prapashtesë, p.sh pjesëmarrës (marr pjesë), kryengritës (ngit-ur krye), marrëveshje (marrë vesh) etj.; ose ndajfolje, si brezahypthi, këmbadorës etj. (Shqipërisë A. e., Gramatika e gjuhës shqipe, 2002, f. 79)

marrëveshje, bashkëkohës, zëvendës, kryengritës

## VII. PËRNGJITJA

„Përngjitja është një mënyrë fjalëformimi, me anën e së cilës formohen fjalë të reja nga njëfjalëzimi i një togfjalëshi, i një togu parafjalor ose i një grupi fjalësh në përgjithësi. Lidhjet sintaksore ndërmjet gjymtyrëve të togfjalëshit a të togut ruhen zakonisht të qarta edhe në strukturën e fjalës së re të përngjitur, p.sh. *trembëdhjetë* (tre mbë dhjetë), *askush* (as kush), *drejtpërdrejt* (drejt për drejt) etj.

Fjalët përngjitura ndeshen më shumë te pjesët e pandyrshueshme të ligjratës. Ato mund të jenë ndajfolje: *gjithnjë*, *matanë*, *anëmbanë*, *sivjet* etj.; prafjalë: *nëpër*, *përmbi*, *përveç* etj.; lidhëza: *nëse*, *ngaqë*, *sesa*, *megjithatë* etj.; pjezësa: *kushedi*, *pothuajse* etj.; pasthirma: *faleminderit*, *tungjatjeta* etj.; përemra të pacaktuar dhe disa ndajfolje përemërore: *kushdo*, *cilido* etj.; numërorët: *njëbëdhjetë* deri në *nëmbëdhjetë* dhe ato që tregojnë dhjetëshe e qindshe, si *njëzet*, *tridhjetë*, *katërqind* etj.“ (Shqipërisë A. e., Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia I, 2002, f. 75)

„Fjalët e përngjitura janë formuar nga përngjitja e dy a më shumë fjalëve të përdorura për një kohë të gjatë pranë njëra – tjetrës.“ (B. Beci, L. Bubani, Z. Gurabardhi, 2000, f. 45). „Fjalët e përngjitura shkruhen njësh si një fjalë e vetme, pa vizë në mes, të cilat janë ngulitur prej kohësh si të tilla në gjuhë si nga ana leksikore, ashtu edhe nga ana gramatikore.“ (SHQIPËRISË A. E., 1973, f. 67)

„Fjalët e përngjitura janë krijuar vetiu, historikisht, nga shkrirja në një njësi e disa fjalëve, që kanë qenë njëra përnjënjë, nuk krijojnë gjedhe, kanë në përbërjen e tyre edhe fjalë shërbyese, kanë shpesh zhvillime fonetike të ndjeshme deri në errësimin e strukturës. Kështu, gjithmonë ka dalë nga *gjithë* dhe *motnë*, në gjymtyrën e dytë të saj ruhet mbaresa e rasës kallëzore (-në); *sonte* nga fjalët *këso* dhe *nate*, pra, ruhet në fund mbaresa e rasës rrjedhore (-e); fjala e përngjitur *ndonjëherë* është formuar nga fjalët *në*, *do*, *një* dhe *herë*, që janë emërtuese e shërbyese, kurse *kushtrim* është formuar nga përngjitja e një fjale të tërë, „kush është trim“. Mirëpo sipas shembullit të tyre, nuk mund të krijojmë fjalë të tjera, sikurse ndodh me fjalët e

përbëra, ku, p.sh. sipas modelit *emër+emër vepruesi (bukëpjekës)*, mund të krijojmë të tjera fjalë, sipas nevojës.“ (Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, 2002, f. 168)

Në prozën e Konicës kemi hasur shumë fjalë të përngjura të cilat i klasifikojmë sipas kategorisë gramatikore të cilës i takojnë.

**Emra të përngjitur:** farefis, gjëza, përgjigje, alishverisjet, gjëgjëza.

**Përemra të përngjitur:** njëfarë, vetvetja, sicilido, cilatdo, tjetërrkush, gjithçka, cilindo, hiçgjë, çfarëdo, secili, kujtudoqoftë.

